# GAZETA SHQIPTARE






Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com






Viti XXIV - Nr. 7606 E martë 31 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)


Opinioni i Ditës

Nga ARMAND SHKULLAKU



## Si po zhduket Tirana e romaneve të Kadaresë?

Në debatin e madh mbi fatin e godinës historike të Teatrit Kombëtar, ka munguar zëri i atyre që njihen si autoritete morale të shoqërisë...

Vijon në faqen 20

Dje në "Evropa e Lirë"

Nga BEKIM BISLIMI



## Vizitat e pamundura zyrtare në Serbi

Shteti i Serbisë, në vazhdimësi po e shkel marrëveshjen e Brukselit për lëvizje të lirë dhe për vizitat e zyrtarëve të Kosovës në territorin e shtetit serb...

Vijon në faqen 21

LISTA ME PERFITUESIT NE TE GJITHE VENDIN DHE HAPAT PER TE MARRE TAPINE

# NDERTUAN PA LEJE, 1476 VETA PERFITOJNE LEGALIZIM

ALUIZNI: Sa do të jetë sipërfaqja e tokës që do të marrë çdo familje në Kavajë, Kukës, Krujë, Gjirokastër, Durrës, Elbasan dhe Korçë



*(Në foto)* Ndërtime pa leje

Në faqet 10-12



Prokurori i Krimeve të Rënda, Besnik Muçi para KPK

## Vetingu, në "sitë" anëtari i fundit i Gjykatës së Lartë, Medi Bici. Ja raporti

Shkarkohen nga detyra gjyqtarët Bledar Abdullai dhe Shkëlzen Selimi

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar ditën e djeshme seancën dëgjimore me anëtarin e fundit të Gjykatës së Lartë, Medi Bicin. Ai u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të komisionit. Sipas Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, Bici ka bërë deklarime të rreme. Në raportin e ILDKPI ...

Në faqen 5

RAPORTI I DASH

## "Shqipëria e vështirë për biznes, prokurimet ngushtuan konkurrencën"

Në faqen 2

HOMAZHET E MESAZHET

## Shuhet ish-ministri Luan Hajdaraga, Braçe: Si na shpëtoi jetën kur PS nuk ishte kjo

Në faqen 4

RREFEHET AUTORI

## Tritoli në banesën e Dacit, Brahaj: Më paguan 5 mijë euro, e bleva në Fushë-Krujë

Në faqen 9

SI U ZBULUA SITUATA

## Vrasja e dyfishtë në Shkodër, prokuroria: Ish-polici Bërcana dhe ekzekutori njiheshin

Në faqen 6

PRESIDENTI: INKURAJOJ DIALOGUN MES PALEVE



## Magjistratura, Meta: Nxitja e konfliktit nuk i shërben reformës në drejtësi

Në faqen 3

Dekania e Juridikut: Ofrojmë cilësi, standarde të larta dhe mundësi të shumta punësimi

## "Luarasi" diplomon të parët me master në "Siguria dhe Rendi Publik"

*Rezana Konomi: Pse duhet ta zgjidhni këtë universitet elitar*

Nga VOLTIZA DURO

Ditën e djeshme, në Kolegjin Universitar "Luarasi" është finalizuar me sukses përfundimi i studimeve të programit master profesional "Siguria dhe Rendi Publik. Të diplomuarit e brezit të parë



në këtë fushë u shprehën tejet të kënaqur, pasi "Luarasi" u ofroi mundësinë e artë për të thelluar dijet akademike e për të ndryshuar këndvështrimin e tyre, përsa i përket sigurisë dhe rendit publik. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", dekania ...

Në faqen 7

INTEGRIMI

REAGIMET

## Bushati në Gjermani: 12 muajt e ardhshëm do i shfrytëzojmë maksimalisht

# Ministri gjerman: Aktorët politikë në Shqipëri të mbështesin reformat

## *Maas: Keni arritur rezultate, përpjekjet janë impresionuese*

Darina Tanushi

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati ishte dje në Gjermani, ku zhvilloi një takim me Ministrin e Jashtëm gjerman, Haiko Maas. Ministrat diskutuan mbi marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve dhe kontributin e madh që Gjermania ka dhënë për Shqipërinë dhe perspektivën e saj të integrimit në Bashkimin Evropian. Në këtë kuadër u ra dakord që axhenda të vijojë me intensitet të plotë. Ministri Bushati falënderoi Gjermaninë për qëndrimin e qartë për sa i takon vendimmarrjes së fundit të BE-së. "Rruga jonë është e qartë për sa i përket 2019-ës dhe 12 muajt e ardhshëm do t'i shfrytëzojmë maksimalisht, duke punuar ngushtësisht me Komisionin Evropian për procesin "screening", nënvizoi Bushati. Ministri Maas nënvizoi se Shqipëria është një partner i rëndësishëm dhe spirancë stabiliteti. Duke vlerësuar reformat e ndërmarra nga Shqipëria si impresionuese dhe shembull për rajonin sa i takon reformës në drejtësi, ai shtoi se, "është vendimtare që kjo rrugë të vazhdojë", ndërsa u bëri thirrje aktorëve politikë në vend të mbështesin këto reforma të rëndësishme për vitin 2019. Ministri Maas shprehu bindjen se integrimi i Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian është në interesin e kësaj të fundit për të shmangur shtrirjen e ndikimit të forcave të treta në rajon. Në një postim në "Twitter" pas takimit që pati me homologun shqiptar Ditmir Bushati, kryediplomati gjerman shkruan se shqiptarët kanë çdo arsye të jenë krenarë për këtë. Në takimin me Bushatin, ministri i Jashtëm gjerman tha se është në "interesin strategjik" të Bashkimit Evropian të zgjerohet në Ballkanin Perëndimor, sepse përndryshe Kina dhe Rusia do të fitojnë ndikim në vendet e rajonit. Heiko Maas tha të hënën se Maqedonia dhe Shqipëria kanë filluar të vënë në vend reformat e kërkuara për anëtarësimin në BE. Maas tha se ai "është i bindur se njerëzit në Ballkanin Perëndimor duan të jetojnë ashtu siç bëjmë në Evropë dhe jo në mënyrën duan të jetojnë njerëzit në Kinë apo Rusi". "Gjermania - shtoi Maas - është shumë, shumë pozitive për zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor, sepse jemi të bindur se është në interesin strategjik të një Evrope të lirë. Të dy ministrat u ndalën edhe tek siguria dhe klima me të cilin përballet Ballkani Perëndimor dhe roli i Shqipërisë si faktor paqeje dhe stabiliteti. Për ministrin Bushati, klima e sigurisë në rajon do të vijë vetëm duke u përmirësuar për sa kohë që perspektiva evropiane e rajonit është e qartë dhe konkretizohet nga instrumente dhe veprime konkrete. Ministrat Bushati dhe Maas u ndalën dhe tek bashkëpunimi në kuadër të OSBE-së si dhe për shkollën e magjistraturës.



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati dhe ministri i Jashtëm gjerman, Haiko Maas

**FRIKA NGA RUSIA**

Në takimin me Bushatin, ministri i Jashtëm gjerman tha se është në "interesin strategjik" të Bashkimit Evropian të zgjerohet në Ballkanin Perëndimor, sepse përndryshe Kina dhe Rusia do të fitojnë ndikim në vendet e rajonit.



## Komisioneri i Zgjerimit për "Euroaktiv", Hahn: Shqipëria, progres me reformat

Komisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn është i kënaqur me strategjinë e Ballkanit Perëndimor, për shkak se ka nxitur një dinamikë të re në rajon. Gjatë një interviste për "Euroaktiv", Hahn thekson se Shqipëria ka bërë progres të dukshëm, megjithatë lutet për realizimin e reformave. "Shqipëria, e cila ka dalë nga hija e së shkuarës, i ka lënë vëzhguesit të befasuar këndshëm. Vendi ka bërë përparim të mirë në zbatimin e prioriteteve të reformës, veçanërisht kur është fjala për reformën shumë ambicioze të gjyqësorit. Qeveria ka demonstruar gjithashtu unitet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Shqipëria, ashtu si ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, po punon për zgjidhjen e çështjeve të hapura kufitare dhe në



përgjithësi kërkon marrëdhënie të mira fqinjësore. Për shkak të përparimit të konsiderueshëm të bërë nga të dyja vendet, Komisioni Evropian ka rekomanduar që negociatat e pranimit të hapen me Shqipërinë dhe Maqedoninë", - është shprehur komisioneri, Hahn. I pyetur për skepticizmin e disa shteteve anëtare për rekomandimin e Komisionit për të hapur negociatat e pranimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë, Hahn tha se integrimi në BE i Ballkanit Perëndimor mbi të gjitha është një investim në sigurinë dhe stabilitetin e Bashkimit European. "Zgjerimi i Ballkanit Perëndimor është më i rëndësishëm se kurrë. Ballkani Perëndimor është i rrethuar nga shtetet anëtare të BE dhe i përket Evropës gjeografikisht, historikisht dhe kulturalisht. Është në interesin më të mirë të BE-së që të sigurojë stabilitet dhe prosperitet në lagjen e tij të afërt. Parimi im për zgjerim është të eksportosh stabilitet në vend të importimit të paqëndrueshmërisë. Në këtë kuptim, integrimi në BE i Ballkanit Perëndimor është një investim në sigurinë dhe stabilitetin e bashkimit", - tha Hahn.

## DASH: Përdorimi në rritje i kontratave të PPP ka ngushtuar mundësitë për konkurrencë

Departamenti Amerikan i Shtetit në raportin e fundit për klimën e investimeve për Shqipërinë për vitin 2018 e konsideron vendin tonë si të vështirë për të bërë biznes, pasi favorizohen kompanitë e lidhura me politikën. Raporti thekson edhe shqetësimet për korrupsionin, mungesën e transparencës në tendera, projektet e Partneritetit Publik Privat, të cilat vlerësohet se kanë kufizuar konkurrencën. Po ashtu, tjetërsimi i pronësisë është një tjetër problem që kanë raportuar investitorët e huaj. "Investitorët raportojnë shqetësime të vazhdueshme, pasi rregullatorët përdorin legjislacionin dhe rregulloret e vështira për t'u interpretuar, si mjete për të dekurajuar investitorët e huaj dhe për të favorizuar kompanitë e lidhura me politikën. Rregulloret dhe ligjet që rregullojnë veprimtarinë e biznesit ndryshojnë shpesh dhe pa konsultime kuptimplota me komunitetin e biznesit. Investitorët e huaj të mëdhenj raportojnë presion për të punësuar nënkontraktorë të lidhur politikisht dhe shprehin shqetësimin për pajtueshmërinë me Aktin e Praktikave të Korruptimeve të Huaja gjatë operimit në Shqipëri", thuhet në raport. "Raportet e korrupsionit në prokurimin e qeverisë janë të zakonshme. Përdorimi në rritje i kontratave të Partneritetit Publik Privat (PPP) ka ngushtuar mundësitë për konkurrencë, përfshirë edhe investitorët e huaj, në infrastrukturë dhe sektorë të tjerë. Analizat e dobëta kosto-përfitim dhe mungesa e ekspertizës teknike në hartimin dhe monitorimin e kontratave PPP janë shqetësime të vazhdueshme. Qeveria kishte nënshkruar më shumë se 200 kontrata PPP deri në fund të vitit 2017", vijon më tej raporti. Të drejtat e pronës mbeten një sfidë tjetër në Shqipëri, pasi titulli i qartë është i vështirë për t'u marrë. Po ashtu, kompensimi për tokën e konfiskuar nga regjimi i mëparshëm komunist është i vështirë për t'u marrë dhe i papërshtatshëm. Ndërkohë, agjencia e ngarkuar me çështjen e ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme shpesh vepron pa konsultime të plota dhe nuk ndjek procedurat", thuhet gjithashtu në raport.




REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



# Protesta



**MIRELA BOGDANI**

Ish-anëtarja e Këshillit Bashkiak të Tiranës, që i përkiste FRD-së së drejtuar nga Bamir Topi dhe që u largua nga ky grupim, Mirela Bogadani iu bashkua dje, protestës për teatrin. "Veprimit që mora të enjten i vuri vulën teatrit. Kishte edhe gjëra të tjera. Puna është tek identiteti i trashëgimisë së Tiranës", tha Bogdani në protestë. Sipas saj, trualli te Tetari Kombëtar është tokë publike, por çështja nuk erdhi kurrë për diskutim në këshillin bashkiak.




## Vasili: Çështja e "Teatrit" ndau përfundimisht qytetarët nga vandalët

Kreu i grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili, është shprehur se çështja e "Teatrit", ndau përfundimisht "qytetarët nga vandalet, të ndershmit nga moralprishurit dhe shtetarët nga banditët me pushtet". Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", ai akuzon hapur ata që i quan "Heronjtë lëpirës të kockës së teatrit". Sipas deputetit të LSI, "të gjithë të komisionuarit me para ose në natyrë, politike e bashkiake qofshin shpërblimet - janë lëshuar me vërtik e me klithma mbi kockën e teatrit. Sapo kocka u largohet pak, kuisin me të qarë dhe me egërsi, që ta afrojnë prapë për ta lëpirë sërish". "Qytetarë, që kanë bërë hasha qytetin e tyre ku lindën dhe u rritën, për hatër të kockës pështyjnë mbi veten dhe të shkuarën e familjeve të tyre qytetare të vjetra, sepse halli i kockës ua kërkon. Të kompleksuar në mënyrë qesharake, këta 'heronj' të kockës gërmojnë shembuj dhe analogji idiote pa asnjë lidhje anë e mbanë globit, që të justifikojnë gllabërimën e kockës së teatrit. Me të shkuara qesharake ku pozicionet, parimet, pronarët, i kanë ndryshuar aq shpesh sa prostitutat klientët, këta heronj të kockës së teatrit vrasin miza mbi pellgje ujërash të zeza morali, ku kanë gjalluar e jetuar prej vitesh", vijoi komentin e tij Vasili.

### Presidenti shmang replikat me Veliajn për teatrin: T'i referohet dekretit

# Magjistratura, Ilir Meta: Konflikti nuk i shërben reformës në drejtësi

## "Inkurajoj vetëm dialogun për të zgjidhur çdo çështje"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës kërkoi dje dialog nga të gjitha palët politike. I ndodhur për një vizitë në Pustec, Meta reagoi për herë të parë për debatin që lindi mes maxhorancës e opozitës në Kuvend, për ligjin e shkollës së Magjistraturës. Kreu i shtetit tha se nxitja e konflikteve nuk i shërben reformës në drejtësi dhe dialogu është mënyra e vetme për zgjidhje transparente e me integritet. "Unë jam i bindur se nxitja e konfliktit as nuk i ka shërbyer deri më tani reformës në drejtësi dhe as nuk do t'i shërbejë në të ardhmen. Vendi ka nevojë për një reformë në drejtësi, e cila bazohet fort te pavarësia e institucioneve të reja të drejtësisë, te integriteti i krijimit të tyre. Dhe në këtë drejtim, unë inkurajoj vetëm dialogun për të zgjidhur çdo çështje në mënyrën më transparente dhe me integritet", deklaroi Meta. I pyetur në lidhje me vakancën e krijuar në Gjykatën Kushtetuese dhe atë të Lartë, Meta u shpreh: "Besoj se duhen të ndërmerren sa më parë të gjitha ato hapa, që përforcojnë efektet pozitive të reformës në drejtësi, por pa krijuar kurrsesi boshllëk apo paralizë të institucioneve më të rëndësishme të drejtësisë". "Është për të ardhur keq që po kalojnë dy muaj nga përfundimet e fundit të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian dhe ende nuk ka një vullnet të përbashkët për të lexuar në mënyrë objektive të gjitha ato kërkesa, të cilat vendi duhet të plotësojë, në mënyrë që të mos kërkojnë përsëri fajtorë qershorin e ardhshëm për çdo dështim në të ardhmen", u shpreh presidenti, referuar rekomandimeve të Këshillit të BE-së për çeljen e negociatave. Sipas tij, "reforma mund të ecë përpara vetëm kur të gjithë përpiqen të respektojnë Kushtetutën, frymën e Kushtetutës dhe njëkohësisht larg çdo tentative për ta politizuar atë në ekstrem, pasi çdo cenim i integritetit së ecurisë së krijimit të institucioneve të reja nuk i shërben besueshmërisë dhe efektshmërisë së kësaj reforme".

**TEATRI**

I pyetur nga gazetarët për deklaratat e kryebashkiakut Erion Veliaj për kthimin në Kuvend të ligjit të teatrit, kreu i shtetit shmangu replikën direkte, ndërsa referoi vendimin me 9 argumente si përgjigje për çdo kritik. "Nuk kam asnjë koment, përveç faktit se cilido që ka kontestime apo vërejtje për kthimin e ligjit, e ftoj që t'i referohet gjithmonë faqes zyrtare të Presidentit të Republikës, pasi jam i sigurt që argumentet, të cilat janë dhënë nga Institucioni i Presidentit bazohen vetëm në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në marrëveshjet ndërkombëtare ku ne jemi palë dhe të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar dhe padyshim në të gjithë legjislacionin tonë në fuqi dhe gjithmonë duke vënë në plan të parë interesin tonë kombëtar dhe publik", u shpreh Meta. Presidenti Meta ishte në Bashkinë e Pustecit, ku përshëndeti festën lokale të Shën Marenës. Ai u prit në fshatin Gollomboç nga autoritetet vendore dhe dhjetëra banorë të zonës, të cilët e falënderuan për vëmendjen e veçantë që i kushton këtij zone, si dhe pakicës kombëtare maqedonase të saj. Më pas, Presidenti i Republikës vizitoi Manastirin e Shën Marenës, ku u përshëndet me pelegrinët e shumtë të pranishëm dhe mori pjesë në festën e shenjtë fetare.



Presidenti Ilir Meta, dje në Pustec

**NEGOCIATAT**

"Është për të ardhur keq që po kalojnë dy muaj nga përfundimet e fundit të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian dhe ende nuk ka një vullnet të përbashkët për të lexuar në mënyrë objektive të gjitha ato kërkesa, të cilat vendi duhet të plotësojë në mënyrë që mos të kërkojnë përsëri fajtorë qershorin e ardhshëm për çdo dështim në të ardhmen", u shpreh presidenti.

### Kryebashkiaku i Tiranës me FRESSH: Projekti u sabotua për 40 ditë

## 'Teatri', Veliaj: Presidenti na tha "gjeni gjuhën me aktorët" dhe ne i bindëm në fund



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj gjatë takimit me të rinjtë e FRESSH-it në Jalë hodhi akuza ndaj deputetëve të opozitës, që sipas tij tentuan ta sabotonin me çdo kusht ndërtimin e teatrit të ri. Por, pavarësisht vështirësive dhe vonesave, Veliaj garantoi të rinjtë socialistë që projekti për teatrin do të realizohet dhe nuk ka kthim pas. "Në fillim patëm një histeri kolektive, kurse aktorët që punojnë aty ishin të shqetësuar. Presidenti i Republikës bëri një thirrje dhe tha: 'Kryetari i bashkisë të gjejë gjuhën me aktorët, që ne të ecim përpara'! Bëmë një takim me aktorët, një me urbanistët, një me arkitektët, një me të gjithë së bashku. U treguam projektin, në fund aktorët u bindën; pra ata që ishin grupi legjitim, që ka vetë interes, u bind. Pasi u bindën aktorët, politika e mbrapshtë, që nuk do që t'i shkojë asgjë mbarë Shqipërisë, tha: "Ou, na u prish plani, tani o burra ta marrim vetë kontrollin e kësaj dhe me ç'na ka ngelur nga ata të lodrave, ç'a kemi portale, hajde ta sabotojmë me çdo kusht! Projekti u sabotua vetëm për 40 ditë. Në shtator do të futemi në fazën e tretë, ku politika e mbrapshtë do të mundet sërish me votat që populli shqiptar i ka dhënë Tiranës dhe Shqipërisë për ndryshim", tha Veliaj. Ai renditi edhe një sërë nismash të mëparshme, të cilat në fillim hasën rezistencë, por në përfundim rezultuan të suksesshme dhe u vlerësuan. Veliaj theksoi se përkundër shumë politikanëve që me sjelljet e tyre ushqejnë sherrin, detyra jonë është të ushqejmë punën, dashurinë për vendin dhe për njëri-tjetrin. "Është shumë e rëndësishme të kuptojmë se pavarësisht detyrave tona në FRESSH, në PS, në qeveri, në bashki, misioni është një: ta bëjmë Tiranën, ta bëjmë Shqipërinë një vend dinjitoz evropian", u shpreh Veliaj. Ai foli edhe për zgjedhjet e ardhshme vendore, duke thënë se PS do të hyjë në garë për të fituar dhe për treguar kryeqytetasve se çfarë mund të bëhet më shumë nga sa është bërë deri më sot.

### Braçe rrëfen historinë: Si na shpëtoi jetën Hajdaraga, ka qenë një kohë kur PS nuk ishte kjo

# Ndahet nga jeta ish-ministri Luan Hajdaraga, Rama e Meta: Burrë i paqtë

## Sot, ceremonia e homazheve në sallën e Kuvendit

Është ndarë nga jeta në moshën 69-vjeçare ish-ministri i Mbrojtjes, Luan Hajdaraga. Ish-deputeti dhe nënkryetar i Partisë Socialiste për shumë vite pësoi disa muaj më parë një hemorragji në tru, teksa kthehej nga Struga, ku kishte shkuar për të dhënë mësim në universitetin e atij qyteti. Ai u shtrua me urgjencë në spital, ndërsa më datën 23 maj qeveria akordoi 1.9 mln lekë për trajtimin mjekësor të tij. Por gjendja e tij u përmirësua dhe pas trajtimit në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Hajdaraga la ambientet e spitalit. Burime nga familja i thanë "BalkanWeb", se dje ai pësoi arrest kardiorespirator dhe me gjithë ndihmën e dhënë në QSUT, nuk mundi të përballonte dot për të qëndruar në jetë. Kuvendi i Shqipërisë do të organizojë sot një ceremoni homazhesh në ndër të kujtimit të ish-ministrit të Mbrojtjes, Luan Hajdaraga. Sipas informacioneve zyrtare, homazhet do të mbahen në sallën e seancave plenare ditën e nesërme nga ora 10:00-12:00. Ndërkohë, pas homazheve, Hajdaraga do të përcillet për në banesën e fundit në orën 13:00, ku trupi i tij do të prehet në varrezat e Tufinës.

**NGUSHËLLIMET**

Për ndarjen nga jeta të ish-ministrit Hajdaraga pati dje mjaft reagime. Miq e bashkëpunëtorë të tij veçanërisht nga PS e LSI shprehën ngushëllimet për familjarët e ish-ministrit. Presidenti i Republikës, Ilir Meta, duke e cilësuar "mik të vjetër dhe të dashur" shprehet në mesazhin e tij: "Luani mbetet një nga përkrahësit më të vendosur të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe si ministër i ngarkuar i Punëve të Jashtme. Ai dha kontributin e tij të rëndësishëm në këtë proces. Me humbjen e tij opinioni publik shqiptar humbi një nga analistët më në zë dhe objektivë të çështjeve të sigurisë, atyre të politikës së jashtme, por edhe të problemeve sociale për të cilat ai fliste me pasionin e tij të rinisë". Kryeministri Edi Rama u shpreh: "I trishtuar për lajmin e ndarjes nga jeta të mikut tim, Luan Hajdaraga. Burrë i paqtë e i arsyeshëm, që diti gjithnjë të mos prishë qejf me asnjë. U prehtë në paqe!". Ndërsa kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi shkroi në mesazhin ngushëllues për familjen e ish-ministrit: "Luan Hajdaraga ishte një njeri i rrallë, që ia kushtoi jetën, aftësitë dhe kontributin e tij të shquar arsimit, kulturës, politikës dhe interesit publik. Si bashkëthemelues dhe zëvendëskryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë, Luan Hajdaraga kontribuoi si rrallëkush me kapacitetet, pasionin dhe përkushtimi e tij për ndërtimin e së majtës moderne shqiptare dhe përpunimin e zbatimin të programit të saj politik dhe qeverisës", shkroi Ruçi.

**RRËFIMI I BRAÇES**

Deputeti Erjon Braçe veç ngushëllimeve për humbjen e ish-kolegut të tij socialistit, Luan Hajdaraga ka rrëfyer edhe sakrificat që kanë bërë gjatë betejave politike. Nëpërmjet një fotoje të shkrepur vite më parë, të postuar në adresën e tij zyrtare në "Instagram", deputeti socialist shprehet: "Nuk dua të të përcjell nesër Luan, ishte bukur me ty si shok, si mik e si vëlla i madh", e nis Braçe postimin e tij.

"Ka qenë një kohë, kur Partia Socialiste nuk ishte kjo e sotmja. Kohë e vështirë, betejë deri në luftë për çdo inç në territor", vijon Braçe, duke thënë se me Hjadaragën është njohur në Partinë Socialiste. Braçe vijon duke thënë se nuk është njohur "në salla mbledhjesh apo Kuvend - si këtu, asfare. Në kabinën e një 'Land Rover'-i të bardhë, tek shinat e trenit në të dalë të Lushnjës, në një postbllok armiqësor të policisë politike, gjatë turit për Referendumin e Kushtetutës në vitin 1994! Ndjeu kurthin, parashikoi sulmin, zbriti nga timoni shoferin e tij dhe nën një shi gurësh vrasës lëvizi makinën për të na shpëtuar jetën", rrëfen Braçe. "Nuk mbaroi aty, në ato 15 kilometra në drejtim të Rrogozhinës, ngjitur pas e duke goditur fort makinën ku ishim e me të cilën po udhëtonim, kishim policinë sekrete të kohës, në sulm për të na bërë të paguanim atë të cilës i shpëtuam në postbllokun e Lushnjës, deri në fund, tek dy rrugët në hyrje të Rrogozhinës", vijon rrëfimin e tij Braçe. Deputeti tregon se Hjadaraga sërish i kishte shpëtuar nga aksidenti pas përplasjes së makinës, vetë Braçen, Servet Pëllumbin, Namik Doklen, Fehmi Abdiun, Vladimir Metanin e të tjerë shokë.



Ish-ministri i Mbrojtjes, Luan Hajdaraga

## Biografia

Luan Hajdaraga ka lidhur në Tiranë më 2 gusht 1948. Ai njihet si politikan dhe diplomat shqiptar, ministër i Punëve të Jashtme në 2003, ministër i Mbrojtjes 1998-2000. Në vitin 1970 u diplomua në Psikologji në Universitetin e Bukureshtit. Në vitin 1973 ai ishte i përfshirë në punën shkencore. Në vitin 1985 u bë drejtor i Institutit të Studimeve Pedagogjike. Në vitin 1991 u bashkua me Partinë Socialiste të Shqipërisë, në 1993-1996 ai ishte nënkryetar i partisë. Si përfaqësues i tij, ai u ul në vitet 1992-2001 në Parlamentin shqiptar. Në vitin 1998, ai mori portofolin e ministrit të Mbrojtjes, në korrik 2000 dha dorëheqjen. Në 2001-2003 u zgjodh zëvendësministër i Punëve të Jashtme. Në vitin 2008 ai iu rikthye punës akademike. Ai është autor i disa punimeve shkencore në fushën e psikologjisë eksperimentale dhe psikologjisë së fëmijëve.

## PD: Me ikjen e Hajdaragës, PS humbi një nga ithtarët e evropianizimit

Pas ndarjes nga jeta ditën e sotme të ish-themeluesit të Partisë Socialiste, Luan Hajdaraga, një mesazh ngushëllimi vjen edhe nga PD. "Partia Demokratike shpreh ngushëllimet e saj më të thella për ndarjen nga jeta të Luan Hajdaragës, protagonist i zhvillimeve të së majtës shqiptare gjatë 28 viteve të fundit. Hajdaraga ishte një kontribuues i jetës politike pluraliste në Shqipëri dhe luajti një rol të rëndësishëm në formësimin e një të majte shqiptare, që mbështeste alternativën euroatlantiste. Si nënkryetar i PS dhe më pas si ministër i Mbrojtjes apo zëvendësministër i Jashtëm, profesori i njohur i psikologjisë dha kontribut në normalizimin e jetës politike në vend, në zbatimin e një diplomacie pa ndikime partiake dhe mori pjesë aktive në aksionin mbarëkombëtar për zgjidhjen e krizës së të shpërngulurve shqiptarë të Kosovës". "Me ndarjen e tij nga jeta, familja humbi njeriun e saj më të shtrenjtë, Partia Socialiste njërin nga ithtarët e evropianizimit të saj, kurse Partia Demokratike një kundërshtar të denjë politik", shkruhet në mesazhin e PD.

## Presidenti francez nderon Mimi Kodhelin me "Legjionin e Nderit"

Ish-ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli është nderuar nga Franca me dekoratën më të lartë, "Legjionin e Nderit". Dekorata është akorduar nga presidenti francez, Macrom. Ceremonia është zhvilluar pasditen e djeshme në mjediset e ambasadës franceze në kryeqytet. Të pranishëm në këtë gëzim kanë qenë shumë kolegë të saj nga Partia Socialiste. "Legjioni i Nderit" është dekorata më e lartë që jepet në Francë. Ajo është krijuar nga Napoleon Bonaparti në maj të viti 1802 dhe për herë të parë ajo është dhënë në 15 qershor të 1804-ës. Medalja jepet për trimëri në veprimet ushtarake ose për shërbim ushtarak 20-vjeçar të dalluar, por edhe në rastet e civilëve, kur puna e tyre rrit reputacionin e Francës përmes studimeve, arteve, shkencave, politikës etj. Në medaljen e titullit është koka e Napoleonit, ndërsa nga mbrapa shkruhet motoja "HONNEUR" (nder). Urdhri është dekorimi më i lartë në Francë dhe është i ndarë në pesë shkallë të ndryshme: Chevalier (kalorës), Officier (oficer), Commandeur (komandant), Grand Officier (oficer i madh) dhe Grand'Croix (Kryqi i madh).



**Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :**

*a) Toke are e rregjistruar ne rregjistrin hipotekore me nr pasurie 582/1 , volumi 10 , Faqe 248, ne zonen kadastrale nr 1100 , me siperfaqe totale 3230 m2 , e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder*
*b) Toke are e rregjistruar ne rregjistrin hipotekore me nr pasurie 523/21 , volumi 9 , Faqe 3, ne zonen kadastrale nr 1100 , me siperfaqe totale2360 m2 , e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder.*
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren
**a) Për pasuritë "Toke Are" me sip 3230 m2 , eshte në vleren 439,538 leke .**
**b) Per pasurine "Toke Are " me sip 2360 m2 , eshte në vleren 321,148 leke**
Shitja e pasurise do te behet ( zhvillohet ) me date 06.08.2018 ora 16.16 ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,



## 9 kandidatë për 5 vende në komisionin e pavarur që monitoron organet e drejtësisë

Kuvendi publikoi dje kandidatët që do të konkurrojnë për të zënë 5 vende në komisionin e pavarur që monitorin zbatimin e ligjit për organet e reja të reformës në drejtësi. Bazuar në Vendimin nr.74, datë 31.5.2018 të Kuvendit, në përfundim të afatit të parashikuar në shpalljen për hapjen e procedurës së aplikimit për pesë vende vakante për anëtarë të Komisionit të Pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016, kanë paraqitur shprehjen e interesit dhe dokumentacionin shoqërues kandidatët:

1. Andi Muratej
2. Artan Spahiu
3. Gëzim Allaraj
4. Ilir Kadiu
5. Irena Nino
6. Lindita Rusmali
7. Saimir Shehri
8. Saimir Vishaj
9. Suzana Pasha (Hoti)

### Shkarkohen nga detyra gjyqtarët Bledar Abdullai dhe Shkëlzen Selimi

# Vetingu, në "sitë" anëtari i fundit i Gjykatës së Lartë, Medi Bici

## *Raporti i ILDKPI: Ka fshehje pasurie*

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar ditën e djeshme seancën dëgjimore me anëtarin e fundit të Gjykatës së Lartë, Medi Bicin. Ai u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të komisionit. Sipas Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, Bici ka bërë deklarime të rreme. Në raportin e ILDKPI vlerësohet se gjyqtari nuk ka burime të ligjshme të ardhurash dhe ka fshehje pasurie. Për figurën, DSIK ka konstatuar se gjyqtari i lartë Bici është i përshtatshëm për vijimin e detyrës dhe nuk ka pasur dyshime për përfshirje në afera korruptive, apo kontakte me persona të inkriminuar. Për anën profesionale, KPK vlerëson se Bici ka aftësitë e nevojshme, ndërsa për të janë bërë 15 denoncime nga qytetarët.

**SEANCA DËGJIMORE**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka ndërmarrë një hetim të pavarur për pasurinë e gjyqtarit. KPK ka marrë në shqyrtim një shtëpi katërkatëshe të ndërtuar në Shkozë gjatë viteve 1993-1996 me vlerë 6 milionë lekë, një tokë 2 mijë m2 të përfituar me ligjin 7501, një makinë "Chrysler" me vlerë 10,000 euro, 10,000 euro shpenzime për shkollimin e fëmijëve në vitet 2008-2011 dhe një likuiditet bankar prej 1.8 milionë lekë. Sipas KPK-së, për shtëpinë katërkatëshe me sipërfaqe fillestare prej 130 m2, të ndërtuar midis viteve 1993 dhe 1996, gjyqtari ka mospërputhje midis deklaratave veting dhe atyre periodike 2003 dhe 2010, për sa u përket kateve. Ndërkohë, komisioni i kërkoi Bicit dokumente shtesë për të ardhurat e të vëllait, i cili ka mbuluar 10,000 euro shpenzime shkollimi për fëmijët e tij. Ndryshe nga ILDKPKI, KPK ka ndërmarrë një hetim të thelluar dhe të pavarur, duke mbledhur informacion nga institucionet publike. Pas përfundimit të seancës, Bici sqaroi se ka paraqitur prova të tjera para KPK-së dhe në lidhje me banesën, i konsideronte lapsuse konkluzionet në të cilat kishte dalë ILDKPI. "E thashë edhe në seancë, për mua është një gabim, se s'ka shpjegim tjetër. Është thjesht një harresë. Procesi deri tani besoj që ka qenë korrekt", - u shpreh ai. E ndërsa u pyet për 11 provat e reja që kishte paraqitur për të bindur anëtarët e KPK-së, Bici tha se një nga provat ishin procesverbalet dhe materialet që kishte treguar në lidhje me banesën e tij. "Po çfarë të them unë nga karriera ime e gjatë?! Karriera ime ka qenë se unë kam qenë kryesuesi i trupës numër 1 penale në Gjykatën e Tiranës, anëtar i gjykatës së parë për Krimet e Rënda, që vetëm krimin e organizuar ka gjykuar, kështu që e gjithë karriera ime ka kaluar në çështje penale, përveç viteve që jam në Gjykatën e Lartë, që më ra pjesa për të punuar në Kolegjin Administrativ, ku dhe u specializova mjaft mirë (buzëqesh)". Më tej, Bici bëri një rezyme të karrierës së tij 25-vjeçare në gjyqësor. "Studimet i nisa me shumë vonesë. I përfundova në 1994. Por një vit përpara mbarimit, u emërova ndihmësgjykatës. Jam ndër gjykatësit më të vjetër në Shqipëri. Kam firmosur tri dënime me vdekje dhe të përjetshme. Po kujtoj këtu vendimin për vrasjen e kambistit, çështjen e personit që u konsiderua si urithi i natës dhe vrasjen e gjimnazistes e nënës së saj. Asnjë prej vendimeve të mia nuk është cenuar. Në 2007-ën jam cilësuar edhe gjykatësi i vitit. Me shumë mund ngjita një e nga një shkallët e karrierës. Zotëroj master të nivelit të dytë në të drejtën administrative me medalje ari", u shpreh anëtari i Gjykatës së Lartë. Vendimi për Bicin pritet të shpallet më 31 korrik. Më herët Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi të shkarkojë nga detyra, anëtarin e Gjykatës së Lartë, Shkëlzen Selimin, me argumentin se ka kontakte të papërshtatshme me elementë të inkriminuar. Gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM ka zbuluar se gjyqtari Selimi ka kontakt të drejtpërdrejtë me A.I., për të cilin gjyqtari ka ndërhyrë në vitin 2015 për të ndaluar ekstradimin e tij në Itali. Ky shtetas sipas zbulimeve të ONM-së, rezulton i dënuar për grup kriminal dhe trafik kokaine. Jashtë radhëve të sistemit u nxor dhe Bledar Abdullai, gjykatës në shkallën e parë në kryeqytet, kandidat për Këshillin e Lartë Gjyqësor. Në seancën e kaluar dëgjimore, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konstatoi se Abdullai nuk ka bërë deklarim të saktë të pasurisë së tij. Kështu, subjekti në fjalë dhe personat e bashkëlidhur nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore për të deklaruar disa prona që disponojnë. Gjyqtari ka deklaruar se është investitor në fondin e pensioneve, në një bankë të nivelit të dytë, por nuk ka deklaruar se edhe bashkëshortja e mamaja e tij është aksionere në të njëjtën shoqëri.



Anëtar i Gjykatës së Lartë Medi Bici

**DEKLARATA**

Pas përfundimit të seancës, Bici sqaroi se ka paraqitur prova të tjera para KPK-së dhe në lidhje me banesën i konsideronte lapsuse, konkluzionet në të cilat kishte dalë ILDKPI. "E thashë edhe në seancë, për mua është një gabim, se s'ka shpjegim tjetër. Është thjesht një harresë. Procesi deri tani besoj që ka qenë korrekt", - u shpreh ai.

## Nuk deklaroi një pronë, prokurori Besnik Muçi përpara KPK

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit zhvilloi ditën e djeshme seancë dëgjimore për prokurorin e Krimeve të Rënda, Besnik Muçi. Prokurori ishte i pranishëm vetë në sallë, pa praninë e një avokati. Sipas raportit të ILKDPI, thuhet se subjekti ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin. Po ashtu, thuhet se nuk ka kryer fshehje pasurie dhe ka burime të mjaftueshme financiare. KPK kreu një hetim të thelluar administrativ. Nga verifikimet e KPK rezulton se Muçi, ishkandidat për Prokuror të përkohshëm të Përgjithshëm, ka një tokë truall 366 m2 dhe tokë bujqësore në Pogradec. Po ashtu, ai disponon një apartament në rrugën e "Ali Visha" në Tiranë, i blerë me kursime dhe një hua. Ndërkohë, prokurori disponon edhe një tokë bujqësore 300 m2 në Shkozë, një banesë 78 metra katrore në Rrugën e Elbasanit. Sipas KPK, shtesa e objektit ekzistues në shtëpinë në Tiranë është bërë me kursime nga puna e bashkëshortes, si dhe toka bujqësore 300 m3 2 në Shkozë, me çmim 111 mijë lekë; toka 2 mijë m2 në një fshat të Pogradecit, si dhe 78 m2 shtëpi në Rrugën e Elbasanit, e blerë 75 mijë euro, siguruar nga rroga dhe një hua që ajo ka marrë. Lidhur me truallin 366 m2 në Pogradec nga hetimi rezultoi se aty është ndërtuar një ndërtesë mbi 90 m katrorë, por se ka deklaruar. Thuhet se këtë pronë ai e ka përfituar në kundërshtim me ligjin.



Prokurori i Krimeve të Rënda, Besnik Muçi

## SHISH: Përdorimi i informacionit të klasifikuar në media ekspozon agjentët përballë rreziqeve

Shërbimi Informativ i Shtetit shprehu ditën e djeshme "shqetësimin e thellë për rastet e përsëritura të pasqyrimit në media të informacioneve apo të dhënave që pretendohet se u referohen dokumenteve të hartuara nga SHISH-i ndër vite". SHISH-i i bën me dije opinionit publik se nuk ka asnjë koment specifik për autenticitetin e dokumenteve të pretenduara të inteligjencës. "Megjithatë, SHISH-i nënvizon me forcë se përdorimi i emrit të Shërbimit dhe referimi për format e metodat e punës së tij, me synimin për të siguruar besueshmëri të shtuar të deklaratave apo akuzave në media dhe opinionin publik sjellin një cenim të ndjeshëm të aktivitetit të komunitetit të inteligjencës. Ato rrezikojnë të ndikojnë aftësinë e Shërbimit Informativ për garantimin e sigurisë kombëtare. Shërbimi Informativ i Shtetit vlerëson se çdo shkelje në administrimin e informacionit të klasifikuar, kudo ku ajo ndodh, mund të dëmtojë rëndë punën dhe të ekspozojë punonjësit e Shërbimit përballë rreziqeve të paparashikuara. Shërbimi Informativ i Shtetit thekson se ligjshmëria, objektiviteti dhe sekreti janë parimet bazë të punës së tij. Në këtë kuadër, SHISH-i mbetet i angazhuar të zbatojë me rreptësi procedurat dhe rregullat ligjore gjatë prodhimit, qarkullimit, administrimit, shfrytëzimit, transportimit, transferimit, arkivimit, shumëfishimit, riprodhimit e asgjësimit të informacionit 'sekret shtetëror' të çdo lloji. Në këtë kuadër, SHISH-i do të vazhdojë bashkëpunimin me organet ligjzbatuese, me qëllim mbrojtjen e sigurisë së veprimtarisë së vet, metodave dhe burimeve të informacionit nga ndërhyrjet e paautorizuara", thekson SHISH në një deklaratë për mediat.

### Maksim Hodaj ishte dënuar me 18 vite heqje lirie

# Masakroi bashkëshorten 9 vite më parë, përfundon në pranga 46-vjeçari i shpallur në kërkim



I arrestuari Maksim Hodaj

**VLORË** - Policia e Vlorës ka vënë në pranga një 46-vjeçar, i cili ishte shpallur në kërkim për vrasjen e bashkëshortes së tij. Ngjarje kjo e ndodhur më 4 qershor të vitit 2009, në fshatin Armen. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se bëhet fjalë për shtetasin Maksim Hodaj. Mësohet se Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë e ka dënuar atë me 18 vite burgim për veprën penale të vrasjes. Burime zyrtare nga policia e qytetit bregdetar bënë me dije se Hodaj do të kryejë pjesën e mbetur të dënimit prej 9 vite, 2 muaj e 26 ditë burg. Materialet procedurale në ngarkim të tij iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprimet e mëtejshme.

**VRASJA**
Maksim Hodaj ishte kthyer në shtëpi në gjendje të dehur dhe në rrethana ende të paqarta, në orën 03:00, masakroi për vdekje të shoqen. Ai ishte grindur fillimisht me bashkëshorten dhe e dhunoi atë me grushte e shkelma, derisa ka ardhur goditja fatale, duke i përplasur kokën në dysheme.

**NGJARJA**

Krimi i rëndë ndodhi më 3 qershor të 2009-ës në fshatin Armen, kur Maksim Hodaj, në ato kohë 36 vjeç, rrahu e më pas i përplasi kokën në çimento gruas së tij 33-vjeçare, Luljeta, duke i shkaktuar asaj vdekjen. Siç u raportua në atë kohë, kryefamiljari Hodaj ishte kthyer në shtëpi në gjendje të dehur dhe në rrethana ende të paqarta, në orën 03:00, masakroi për vdekje të shoqen. Ai ishte grindur fillimisht me bashkëshorten dhe e dhunoi atë me grushte e shkelma, derisa ka ardhur goditja fatale, duke i përplasur kokën në dysheme. Nëna e tre fëmijëve, vajzës 13-vjeçare dhe dy djemve, 8 vjeç dhe 8 muajsh ka gjetur vdekjen menjëhershme. Pasi pa të shoqen pa shenja jete, Maksim Hodaj u largua nga vendi i ngjarjes. I kërkuari u arrestua tri vite më pas dhe konkretisht më 25 dhjetor të 2012-ës. Bashkë me të u kapën edhe dy femra, të cilat dyshohej se ishin përfshirë në një rrjet prostitucioni. Ndërsa, Hodaj i shpëtoi sërish drejtësisë. Nuk dihet se si ai arriti të dilte nga burgu.

### "Vrasësi eliminoi edhe bashkëjetuesen e ish-efektivit që të mos linte dëshmitarë"

# Vrasja e dyfishtë në Shkodër, prokuroria: Ish-polici Bërcana dhe ekzekutori njiheshin

## *"Viktima përshëndeti atentatorin pak sekonda para se ai ta qëllonte me plumb në kokë"*

Senad Nikshiqi

**SHKODËR**

Dy javë pas vrasjes ma fioze të ish-efektivit të policisë, Boran Bërcana dhe bashkëjetueses së tij 25-vjeçare, Silvana Ndoci, hetuesit e çështjes kanë zbardhur detaje të reja në lidhje me krimin e dyfishtë që tronditi banorët e Shkodrës dhe jo vetëm. Këto detaje vijnë pak ditë pas deklaratës së drejtorit të Policisë Vendore të Shkodrës, Vehbi Bushati lidhur me ekzekutimin e ish-policit dhe gruas së tij, ngjarje kjo e ndodhur në orët e para të 15 korrikut në vendin e quajtur "Rruga e gjerë", në lagjen "Naim Gjylbegu". Kreu i bluve, i pyetur për këtë çështje u shpreh se ka disa pista hetimi për të cilat po punohet së bashku me prokurorinë për të arritur tek zbardhja e plotë e saj. Mësohet se nga hetimet e kryera janë siguruar të dhëna të rëndësishme, që mund të shërbejnë për të hedhur më shumë dritë rreth vrasjes dhe autorit të mundshëm të krimit. Sipas burimeve nga prokuroria e Shkodrës, ka dyshime të forta se Boran Bërcana dhe ekzekutori kanë pasur njohje me njëri-tjetrin.

**VRASJA E DYFISHTË**
Ish-efektivi i policisë, Boran Bërcana dhe bashkëjetuesja e tij, Silvana Ndoci u ekzekutuan brenda në makinën e tyre në orët e para të mëngjesit të 15 korrikut në lagjen "Naim Gjylbegu" të Shkodrës. Çifti u qëllua për vdekje rreth orës 01:15 të mëngjesit, poshtë pallatit ku jetonin me qira prej 8 muajsh, ndërkohë që trupat e tyre të pajetë e të bërë shoshë nga plumbat u gjetën nga banorët e lagjes në fjalë dhe policia rreth orës 06:40 të mëngjesit.




Viktimat Boran Bërcana dhe Silvana Ndoci

**HETIMI**

Bazuar në skemën e vrasjes dhe veprimet hetimore, hetuesit dyshojnë se vetëm pak sekonda para vrasjes, Boran Bërcana e ka përshëndetur ekzekutorin e tij duke qenë se ata njiheshin. Gjithashtu, burimet pranë organit të akuzës bëjnë me dije se në momentin kur 30-vjeçari Bërcana ka ecur me makinë e tij tip "Benz" me targë AA 006 HA, për të shkuar tek pallati ku banonte me qira, pak metra përpara se të mbërrinte në destinacion mund të jetë përshëndetur me autorin. Kjo përshëndetje që prokuroria dhe policia dyshon çon në konkluzionin se Boran Bërcana dhe autori kanë pasur një njohje, qoftë edhe të thjeshtë mes tyre. Ish-polici që u vra me partneren e tij me 28 plumba ka vijuar gradualisht rrugën me makinën e tij, duke mos e menduar asnjëherë se i njohuri i tij do ta qëllonte për vdekje vetëm pas pak sekondash. Sapo makina e ish-efektivit ka ecur pak metra më përpara, autori e ka ndjekur qetësisht jo me hapa të nxituar për të hequr gjitha dyshimet dhe sapo është afruar, ka qëlluar pa mëshirë duke zbrazur nga arma e tij automatike tip gjermane 28 plumba. Nga detajet e reja që janë zbardhur, mendohet se fillimisht agresori e ka qëlluar në kokë Boran Bërcanën, por duke qenë se makina ka ecur për inerci, atëherë autori i krimit për të qenë i sigurt ka vijuar të qëllojë me breshëri. Bashkëjetuesja e Bërcanës, Silvana Ndoci mund edhe të kishte shpëtuar, por sipas dyshimeve që ka prokuroria, autori e ka qëlluar edhe atë për faktin se ajo e ka parë në fytyrë dhe e ka njohur atë. Në këtë mënyrë, për të mos lënë pas dëshmitarë dhe për të humbur gjurmët, atentatori e ka ekzekutuar edhe 25-vjeçaren. Pasi kreu vrasjen, autori u largua duke shkuar në zonën e 'By Pass'-it të Shkodrës, që është në ndërtim e sipër. Aty braktisi makinën që rezulton e vjedhur në Kosovë dhe armën e krimit duke i vënë flakën për të humbur çdo gjurmë. Policia dhe prokuroria vijojnë hetimet për këtë vrasje të dyfishtë, por ende deri më tani nuk ka diçka konkrete sa i përket identifikimit të autorit të krimit.

**DJALI 2-VJEÇAR**
Djali i mitur i çiftit dyshohet se ka qenë në gjumë në sediljen e pasme të "Benz"-it kur ka ndodhur vrasja. Ndërsa, efektivët e policisë e kanë gjetur atë në prehrin e nënës të mbuluar nga gjaku. 2-vjeçari ka qëndruar për mbi 5 orë brenda makinës, pranë trupave të pajetë të prindërve. Pas këqyrjes së vendit të ngjarjes, policia ka gjetur 23 plumba që janë lëshuar në drejtim të çiftit. Fatmirësisht, fëmija i vogël ka shpëtuar pa marrë asnjë plumb.

**IDENTIKITI I VRASËSIT**
Nga pamjet filmike konstatohet se autori pasi ka kryer vrasjen, ka hipur në mjetin e tij dhe i vetëm është larguar me shpejtësi. Ende është e paqartë nëse ka qenë me apo pa maskë. Disa ekspertë mendojnë se ai ka vepruar i pamaskuar. Ekspertë të tjerë dyshojnë vrasësi ka pasur diçka në fytyrë. Kjo paqartësi vjen për shkak se nga pamjet filmike të kamerave nuk mund të shihet aq mirë. E sigurt është se atentatori ka pasur kapele në kokë dhe është relativisht i gjatë.

### Parandalohet krimi në familje, kapet 33-vjeçari që dhunonte gruan

**MALËSI E MADHE** - Parandalohet një krim brenda familjes në Malësinë e Madhe. Policia ka arritur të arrestojë në kohë rekord autorin, ndërsa ka sekuestruar edhe armën e zjarrit. Sipas bluve, në pranga ka përfunduar 33-vjeçari Fran Shelinaj, banues në fshatin Kastrat, i cili akuzohet se ka dhunuar bashkëshorten e tij, ndërsa kjo e fundit ka mundur të telefonojë policinë dhe të kërkojë ndihmë. "Arrestimi i tij u bë pasi bashkëshortja e tij, shtetasja V.Sh. 25 vjeçe, ka telefonuar policinë dhe ka kërkuar ndihmë, pasi po dhunohej nga bashkëshorti. Falë reagimit të shpejtë, forcat e policisë kanë mbërritur në banesën e tyre duke parandaluar dhunimin e mëtejshëm të shtetases V.Sh. nga ana e bashkëshortit, si dhe gjatë kontrollit të ushtruar është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri automatik. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprat penale 'Armëmbajtje pa leje' e 'Dhuna në Familje'", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

# KOLEGJI UNIVERSITAR "LUARASI"

## INTERVISTA

### Dekania e Juridikut: Ofrojmë cilësi, standarde të larta dhe mundësi të shumta punësimi

# "Luarasi" diplomon brezin e parë në masterin profesional "Siguria dhe Rendi Publik"

## Rezana Konomi: Pse duhet ta zgjidhni këtë universitet elitar

Voltiza Duro

*Ditën e djeshme, në Kolegjin Universitar "Luarasi" është finalizuar me sukses përfundimi i studimeve të programit master profesional "Siguria dhe Rendi Publik. Të diplomuarit e brezit të parë në këtë fushë u shprehën tejet të kënaqur, pasi "Luarasi" u ofroi mundësinë e artë për të thelluar dijet akademike e për të ndryshuar këndvështrimin e tyre, përsa i përket sigurisë dhe rendit publik. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", dekania e Fakultetit Juridik pranë këtij institucioni elitar, Rezana Konomi tregon se pas rezultateve të shkëlqyera të brezit të parë, janë optimistë për vijimësinë e programit. Më tej Konomi thekson për të gjithë maturantët se ata duhet të përzgjedhin "Luarasin" për të siguruar kështu një të ardhme brilante. Dekania e Juridikut pohon se ky institucion siguron cilësinë dhe standardet më të larta të certifikuara tashmë, por ofron edhe mundësi shumë të mira punësimi pas studimeve.*



Dekania e Fakultetit Juridik, Rezana Konomi

**Sot (dje) është zhvilluar ceremonia e diplomimit për studentët e masterit profesional në programin "Siguria dhe rendi publik" në "Luarasi". Ky ishte brezi i parë i të diplomuarve në këtë program studimi?**

Sot (dje) pranë Kolegjit Universitar "Luarasi" u finalizua përfundimi i studimeve të programit të ciklit të dytë, master profesional me kohëzgjatje një vit kalendarik "Siguria dhe Rendi publik". Ky ishte brezi i parë i studentëve dhe natyrisht, vëmendja dhe përkushtimi ka qenë maksimal dhe i dyanshëm, nga stafi akademik, por edhe nga të diplomuarit e këtij programi.

**Si e vlerësojnë të sapodiplomuarit Kolegjin Universitar "Luarasi"?**

Një vit më parë kur startoi ky master profesional, i pari dhe i vetëm i këtij lloji, megjithëse i kishim paraprirë me një studim të detajuar të tregut, ishim para një sfide se çfarë do të ofronim në këtë program studimi, a do të ishim koherentë me kërkesat e tregut dhe sa eficent do të ishte vetë programi, pra me çfarë vlere të shtuar do t'i pajiste studentët. Në këtë ditë të shënuar, të diplomimit të brezit të parë patëm kënaqësinë të dëgjonim pohimin e studentëve se ajo çfarë kishin përfituar i ka vlejtur, jo vetëm se kanë thelluar dijet akademike, por ka ndryshuar edhe këndvështrimin e tyre për vetë konceptin e sigurisë dhe rendit publik.

**Sa do t'u vijë në ndihmë studentëve një master i tillë? Cili target-grup mund ta ndjekë këtë fushë studimi?**

Natyrisht, në ndjekjen e këtij programi kryesisht të interesuar ishin punonjësit aktualë të policisë në të gjitha segmentet. Por target-grupi që mund të ndjekë këtë master është shumë më i gjerë se kaq, madje jo vetëm brenda vendit, por edhe ata që shërbejnë në këto organe në gjithë trojet shqiptare, kjo edhe për faktin se është i vetmi program masteri i këtij lloji. Sot që morëm rezultatet e para të brezit të parë jemi shumë të motivuar dhe mjaft optimistë për vijimësinë dhe benefitet e programit të adresuar nga kërkesat e vetë tregut të punës.

**Prej 30 korrikut kanë nisur aplikimet në universitete. Pse maturantët duhet të zgjedhin Kolegjin Universitar "Luarasi"?**

Por sot është një ditë e veçantë edhe për maturantët, për të cilët nis procedura e aplikimit të zgjedhjes së degës së studimit, por edhe të universitetit. Maturantët janë para një momenti shumë të rëndësishëm dhe të përgjegjshëm sepse duhet të marrin vendime me peshë e përgjegjësi, sepse nga kjo zgjedhje fillon të shkruhet historia e tyre e së ardhmes. Si prind, si edukator, së pari do t'u uroja shumë suksese dhe do t'u këshilloja të jenë të vëmendshëm dhe të përgjegjshëm duke zgjedhur atë degë studimi që iu pëlqen, ku ata shohin të ardhmen e tyre dhe që dinë të bëjnë më mirë dhe me pasion. Por një rëndësi të veçantë ka dhe ku do të studiojnë. Shpesh gabojmë, sepse nuk vlerësojmë si dhe sa duhet treguesit që e bëjnë një institucion të arsimit të lartë të konsiderohet me standarde dhe cilësi të larta. Do t'u këshilloja maturantëve të informohen për akreditimin e programeve mësimore dhe akreditimin institucional. Këto janë indikacione shumë të rëndësishme dhe për transferimin e krediteve dhe të studimeve brenda vendit, por edhe njohjen e programeve jashtë vendit.

**Çfarë ofron ky institucion i arsimit të lartë për studentët?**

Iu bëj thirrje maturantëve që ta shohin Kolegjin Universitar "Luarasi" si një zgjedhje të tyren, sepse jo vetëm që sigurojmë cilësinë dhe standardet më të larta të certifikuara tashmë, por edhe një mundësi shumë të mirë punësimi pas studimeve në të tria fakultetet: Drejtësi, Ekonomi, IT dhe inovacion dhe më larmi programesh studime në të dyja ciklet, ku gjithkush mund të gjejë fushat e veta të interesit.

"Luarasi" ka një traditë të shkëlqyer 15-vjeçare në fushën e arsimit të lartë, ka përballuar sfida dhe ndoshta edhe konkurrencë të pandershme dhe ka ditur të qëndrojë në krye të rankimit të institucioneve të arsimit të lartë, duke siguruar një akreditim institucional maksimal 6-vjeçar. Duhet zgjedhur "Luarasi" sepse është i vetmi me tregues që bëjnë diferencën, sepse është i vetmi që ka nxjerrë studentë që kanë ndjekur studimet në shkollën e magjistraturës dhe sot janë magjistratë apo kandidatë për magjistratë.

**Në bazë të statistikave, sa i sigurt është punësimi pas përfundimit të studimeve në Kolegjin Universitar "Luarasi"?**

"Luarasi" është i vetmi që në tregun e punës është preferencial dhe me një shkallë punësimi 80% që vitin e parë pas përfundimit të studimeve. Duhet të zgjidhni "Luarasin" sepse pas tij qëndron një grup i fuqishëm biznesi, i cili e suporton, por është edhe një urë e rëndësishme lidhëse midis teorisë dhe praktikës, sepse mundëson internship gjatë gjithë kohës së studimeve. Të zgjedhësh "Luarasin" është dhe një zgjedhje e zgjuar, sepse aktualisht ofron tarifa studimi nga më konkurruese dhe ka një politikë bursash për disa kategori studentësh. Pra, të zgjedhësh këtë emër të madh ke zgjedhur një të ardhme të sigurt dhe ke vendosur themele të forta nga ku mund të ndërtosh të gjithë karrierën profesionale për të qenë të spikatur, duke bërë diferencën me gjithë të tjerët që kanë kryer studime të ngjashme.

### AKREDITIMI

"Luarasi" ka një traditë të shkëlqyer 15-vjeçare në fushën e arsimit të lartë, ka përballuar sfida dhe ndoshta edhe konkurrencë të pandershme dhe ka ditur të qëndrojë në krye të rankimit të institucioneve të arsimit të lartë, duke siguruar një akreditim institucional maksimal 6-vjeçar.

### PUNESIMI

"Luarasi" është i vetmi që në tregun e punës është preferencial dhe me një shkallë punësimi 80% që vitin e parë pas përfundimit të studimeve. Duhet të zgjidhni "Luarasin" sepse pas tij qëndron një grup i fuqishëm biznesi, i cili e suporton, por është edhe një urë e rëndësishme lidhëse midis teorisë dhe praktikës, sepse mundëson internship gjatë gjithë kohës së studimeve.



Korrupsioni, dërgohen për gjykim edhe 7 persona të tjerë

# Abuzimi me pronat në Ishëm, në gjyq ish-kyekomunari Sulejman Ibrahimi

## Prokuroria: Ka lidhur kontrata qiraje për dhënie të hapësirës publike me 4 shtetas

**DURRËS**

Prokuroria e Durrësit ka dërguar në gjykatë dosjen për abuzimet me pronat në Ishëm. Nën akuzë janë 8 persona, mes të cilëve edhe ish-kryetari i komunës, Sulejman Ibrahimi, i cili akuzohet për tri vepra penale: "Falsifikim", "Shpërdorim detyre" dhe "Korrupsion pasiv". Gjithashtu, në lidhje me tjetërsimin e pronave në këtë zonë akuzohen edhe shtatë persona të tjerë dhe konkretisht: Shpresa Merdita, Ornela Shëmlikaj, Enver Shima, Fadil Hoxha, Bujar Barushi, Gjergji Çerri dhe Rruzhdi Alla.



Prokuroria e Durësit

**NJOFTIMI I PROKURORISE**

Prokuroria Durrës në korrik 2018 i kërkoi Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 1205, datë 08.07.2015, në ngarkim të të pandehurve:

1.Sulejman Ibrahimi, datëlindja 01.04.1968, lindur dhe banues në Durrës, i padënuar më parë, i hetuar me masë sigurimi "Arrest në Burg".

Akuzuar: Se ka kryer veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004) e kryer në bashkëpunim (rastet I.a,b,c,d), "Shpërdorimi i detyrës" (ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007), (rastet II.a,b,c) dhe "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" e kryer në bashkëpunim.

2.Shpresa Merdita, datëlindja 20.04.1970, lindur dhe banues Durrës, e hetuar me masë sigurimi "Arrest në shtëpi" (vendimi nr. 44, datë 08.02.2018, zëvendësuar me vendimin nr. 44/2, datë 03.04.2018 lënë në fuqi me vendimin nr. 104/10-2018-1110, datë 31.05.2018 të Gjykatës së Apelit, Durrës.

Akuzuar: Se ka kryer veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004) e kryer në bashkëpunim (Rruzhdi Alla) "Falsifikimi i dokumenteve" (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004) dhe "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" e kryer ne bashkëpunim, parashikuar nga neni 186 pgr. 3 - 25, 186 pgr. 2 dhe 259 - 25 të Kodit Penal.

3.Ornela Shëmlikaj, datëlindja 18.03.1994, lindur dhe banues në Ishëm Durrës, e hetuar me masë sigurimi "Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" (vendimi nr. 44/1, datë 10.02.2018).

Akuzuar: Se ka kryer veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" (ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007).

4.Enver Shima, datëlindja 05.05.1950, lindur dhe banues në Kuraten, Ishëm Durrës, i padënuar më parë, i hetuar me masë sigurimi "Arrest në Burg" (vendimi nr. 45, datë 08.02.2018 zëvendësuar me masën "Arrest në shtëpi" vendimi nr. 10-2018-408, datë 22.02.2018 të Gjykatës së Apelit Durrës.

Akuzuar: Se ka kryer veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004) e kryer në bashkëpunim.

5.Fadil Hoxha, datëlindja 01.07.1968, lindur në Ishëm, Durrës, dhe banues në Tiranë, i padënuar më parë, i hetuar me pa masë sigurimi.

Akuzuar: Se ka kryer veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004) nëpërmjet vënies në qarkullim më shumë se njëherë.

6. Bujar Barushi, datëlindja 28.10.1961, lindur dhe banues në Ishëm, Durrës, i padënuar më parë, i hetuar në mungesë dhe pa masë sigurimi.

Akuzuar: Se ka kryer veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004) nëpërmjet vënies në qarkullim, parashikuar nga neni 186 pgr.1 të Kodit Penal.

7.Gjergji Çerri, datëlindja 10.02.1952, lindur dhe banues në Bizë, Durrës, i padënuar më parë, i hetuar me pa masë sigurimi.

Akuzuar: Se ka kryer veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004) nëpërmjet vënies në qarkullim, parashikuar nga neni 186 pgr.1 të Kodit Penal.

8.Rruzhdi Alla, datëlindja 10.06.1953, lindur dhe në Bizë, Ishëm dhe banues në Durrës, i padënuar më parë, i hetuar me pa masë sigurimi.

Akuzuar: Se ka kryer veprën penale "Mashtrimi" dhe "Falsifikimi i dokumenteve" (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004) nëpërmjet vënies në qarkullim.

Faktet për të cilat janë akuzuar të pandehurit kanë të bëjnë me:

1.Katër raste për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" (Ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004) e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186 pgr. 3 - 25 të Kodit Penal.

-Shtetasi Bujar Barushi ka fituar një sipërfaqe toke prej 3586 m2, e ndodhur në fshatin Gjuriçaj.

-Shtetasi Fadil Hoxha ka përfituar një sipërfaqe toke prej 5200 m2.

-Shtetasi Gjergj Çerri ka përfituar një sipërfaqe tokë arë prej 2000 m2, e ndodhur në fshatin Bizë.

-Shtetasi Rruzhdi Alla ka përfituar një sipërfaqe tokë arë prej 5800 m2, e ndodhur në fshatin Bizë.

Shtetasi Sulejman Ibrahimi, në cilësinë e ish- kryetarit të Komunës Ishëm gjatë muajve qershor dhe nëntor të viti 2014 ka lidhur kontrata qiraje për dhënie të hapësirës publike me shtetasit Myftar Lumneshi, Artur Farruku, Kastriot Murati dhe Besmir Agasi.

Në funksion të këtij procedimi, me vendimin Nr. 648/6 datë 28.07.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, është urdhëruar: caktim i masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive duke mos lejuar tjetërsimin e pasurive:

-Pasuria sip. 1450 m2, dhe pasuria me sip. 4350, fshati Bizë, në emër të shtetasit Rruzhdi Alla, aktualisht të dyja këto sipërfaqe në emër të shtetasit Paulin Mlera.

-Pasuria e llojit arë, me sipërfaqe 2000 m2, në emër të shtetasit Gjergji Çerri, aktualisht në emër të shtetasit Vaeld Zhezha.

-Pasuria me sipërfaqe 5200 m2, në emër të shtetasit Fadil Hoxha.

-Pasuria e llojit arë, me sipërfaqe 3586 m2, në emër të shtetasit Bujar Barushi.

-Aksioneve të shoqërisë "Eco Alba Group" sh.p.k, me L21408502V e regjistruar më datë 08.02.2012 në emër të shtetasit iltalian Valerio Bonnano, me seli në fshatin Rrotull, Ishëm, Durrës, në emër të shtetasit Myslym Koni.

---

Ndryshim tarifash në Gjirokastër, Librazhd, Berat, Kuçovë e Poliçan

# Rritje e çmimit të ujit për 5 qytete, nis procedura nga Enti Rregullator



Kanë nisur procedurat për rritjen e tarifave të ujit edhe në 5 qytete të tjera në vend, pas Tiranës, Durrësit e Korçës. Ky proces është marrë në ngarkim nga Enti Rregullator i Ujit. Kanë qenë shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve në Gjirokastër, Librazhd, Berat-Kuçovë dhe Poliçan që kanë kërkuar rritje të çmimeve, jo vetëm për ujin e pijshëm, por edhe për ujërat e ndotura. Deri më tani Enti nuk ka publikuar nivelin e tarifave të kërkuara, por sipas këtij dikasteri, kërkesa bazohet në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj, pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale. Aktualisht në Berat e Kuçovë tarifa e ujit të pijshëm për abonentët familjarë është 48 lekë/m3, në Gjirokastër 43 lekë/m3, në Librazhd 38 lekë/m3, ndërsa në Poliçan 37 lekë/ m3. Ndërkohë që, referuar Raportit të Performancës për vitin 2017, shoqëritë e mësipërme shfaqin një situatë pozitive në drejtim të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes. Ujësjellësi Berat-Kuçovë i mbulon këto kosto në masën 131%, Librazhdi në masën 115%, Gjirokastra në masën 104%, ndërsa më dobët paraqitet vetëm Poliçani, me 61% të mbulimit të kostove. Sipas Entit Rregullator të Ujit, ndryshimi i tarifave luan një rol të rëndësishëm në nivelin e të ardhurave të shoqërisë dhe për rrjedhojë, edhe në mbulimin e kostove. Megjithatë, sipas këtij dikasteri, përmirësimi i situatës financiare të shoqërive UK duhet të vijë jo vetëm nga rritja e tarifave, por edhe nga një menaxhim i mirë i burimeve teknike e financiare. Në vazhdën e reformës në këtë sektor të rëndësishëm, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve ka nënshkruar me shoqëritë e ujësjellësve kontratat e performancës, ndërkohë që në bazë të rezultateve që do të vlerësohen në fund të vitit, do të përcaktohet edhe financimi që do u bëhet këtyre shoqërive nga buxheti i shtetit.

**TARIFAT**

Deri më tani Enti nuk ka publikuar nivelin e tarifave të kërkuara, por sipas këtij dikasteri, kërkesa bazohet në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj, pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale. Aktualisht në Berat e Kuçovë tarifa e ujit të pijshëm për abonentët familjarë është 48 lekë/m3, në Gjirokastër 43 lekë/m3, në Librazhd 38 lekë/m3, ndërsa në Poliçan 37 lekë/ m3.

### Zbardhet ngjarja në Bathore, kamerat e sigurisë filmojnë autorin

# Tritoli në banesën e Dacit, arrestohet Vilson Brahaj

## *23-vjeçari: Më paguan 5 mijë euro, lëndën shpërthyese e bleva në Fushë-Krujë*

Ina Allkanjari

**KAMEZ** - Disa ditë pas shpërthimit të eksplozivit në banesën e familjes Daci në Bathore të Tiranës, policia identifikon dhe vë në pranga autorin. Pas hetimeve në kuadër të operacionit policor të koduar "Pagesa", është bërë e mundur zbardhja e ngjarjes dhe arrestimi i 23-vjeçarit Vilson Brahaj, i cili dyshohet të jetë autori i vendosjes së lëndës eksplozive. Ngjarja ndodhi rreth orës 1 e 30 pas mesnate në datën 27 korrik, ku Brahaj vendosi rreth 500 gramë eksploziv në banesën e Xhelal Dacit në Bathore. Fatmirësisht nga shpërthimi pati vetëm dëme materiale në katin e parë të banesës. Gjatë dëshmisë së dhënë përpara uniformave blu, i riu ka pranuar autorësinë e sulmit me eksploziv. Brahaj e ka justifikuar veprimin e tij duke u shprehur se gjithçka e ka bërë për para, pasi për vendosjen e eksplozivit u pagua me shumën 5 mijë euro. "Kisha nevojë për lekë prandaj e bëra. Jam i papunë, s'kam asnjë të ardhur. Për të vënë eksploziv tek shtëpia e Xhelalit më paguan 5 mijë euro. Lëndën shpërthyese e bleva tek disa djem në Fushë-Krujë. Ata ma montuan dhe unë vetëm sa e vura te shtëpia. Xhelalin e njoh, se jetoj në Kamëz, por nuk kam asgjë me të. E bëra vetëm për para", ka deklaruar 23-vjeçari Vilson Brahaj para policisë. Gjithashtu në dëshminë e tij, 23-vjeçari tregoi vendin ku kishte fshehur makinën dhe rrobat menjëherë pas ngjarjes. Policia ra në gjurmë të autorit duke këqyrur kamerat e sigurisë së vetë banesës, por edhe objekteve përreth. Një kamera në zonë kishte kapur targën e makinës me të cilën u larguа 23-vjeçari nga vendi i ngjarjes çka e ndihmoi policinë në identifikimin e autorit. Por, Brahaj nuk është një emër i panjohur për policinë, i riu rezulton me precedentë penalë dhe ka qenë i dënuar për vjedhje. Kujtojmë se Xhelal Daci është babai i Gazmend Dacit, i cili aktualisht po vuan dënimin me 35 vjet burg për vrasjen e Valmir Kolaverit dhe plagosjen e vëllait të tij, ngjarje kjo e ndodhur në vitin 2015. Dyshohet se Brahaj është paguar nga familja Kolaveri për vendosjen e lëndës plasëse. Më herët në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", motra e Gazmir Dacit akuzoi familjen Kolaveri për sulmin, duke treguar se ky është rasti i katërt që kërcënohen nëpërmjet vendosjes së tritolit, ndërsa një rast tjetër kanë tentuar të ekzekutojnë në ambientet e burgut vëllain e saj. "Është hera e pestë që na sulmojnë. Dy herë na është vendosur tritol në shtëpi, dy herë te lokali që është biznes i familjes sonë dhe një herë kanë tentuar të vrasin vëllain në burg. Kemi kërkuar ndihmë nga shteti, nuk na japin asnjë lloj zgjidhjeje, kemi nevojë për mbrojtje", u shpreh motra e Gazmir Dacit, në gjendje të rënduar psikologjike nga sulmi.


Vilson Brahaj

**DËSHMIA**
"Kisha nevojë për lekë prandaj e bëra. Jam i papunë, s'kam asnjë të ardhur. Për të vënë eksploziv tek shtëpia e Xhelalit më paguan 5 mijë euro. Lëndën shpërthyese e bleva tek disa djem në Fushë-Krujë. Ata ma montuan dhe unë vetëm sa e vura te shtëpia. Xhelalin e njoh se jetoj në Kamëz, por nuk kam asgjë me të. E bëra vetëm për para", ka deklaruar 23-vjeçari Vilson Brahaj para policisë.

**ARRESTIMI**

"Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Numër 5 në Kamëz, në bashkëpunim me specialistët e Seksionit Kundër Krimeve ndaj Jetës dhe Pronës në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, pas një pune profesionale si dhe bazuar në informacionet e grumbulluara në rrugë operative, mbrëmjen e së dielës kanë finalizuar me sukses operacionin policor të koduar 'Pagesa', ku është bërë e mundur zbardhja e ngjarjes së ndodhur më datë 27.07.2018, në rrugën 'Martin Camaj', Bathore, ku në banesën e shtetasit Xh.D. është vendosur lëndë shpërthyese, duke shkaktuar vetëm dëme materiale. Në kuadër të operacionit u bë kapja dhe ndalimi i autorit të dyshuar të kësaj ngjarjeje, Vilson Brahaj, 23 vjeç, lindur në Kukës dhe banues në Kamëz, Tiranë. Nga tërësia e veprimeve të kryera dyshohet se ky shtetas kundrejt pagesës ka vendosur sasinë prej 500 gramë lëndë plasëse në banesën e shtetasit XH.D.. Autori i dyshuar pas kryerjes së krimit ka hedhur në lumë tek 'Ura e Tapizës' rrobat e përdorura gjatë kryerjes së krimit, ndërsa automjetin e kishte fshehur në një bodrum afër 'Urës së Tapizës'. Për arsye hetimore nuk bëjmë me dije të dhënë të tjera", thuhet në njoftimin e policisë. Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar automjeti, të cilin autori i dyshuar e ka përdorur për të transportuar dhe shpërthyer lëndën plasëse në banesën e shtetasit Xhelal Daci. Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasit Vilson Brahaj, për veprën penale "Shkatërrimi i pronës me eksploziv".

### Prokuroria: Kemi përgjimet ambientale dhe prova të tjera. Gjykata i lë në burg

# Tentuan të grabisnin banesën e ish-tregtarit, 2 të arrestuarit: Nuk kemi gisht në ngjarje

## *Pëllumb Kolbucaj: Më kapën pas shëtitjes në pedonale. S'kisha kapuç në kokë, ma vuri policia dhe më dhunoi*

**SHKODËR**

Gjykata e Shkodrës dje vlerësoi të ligjshëm ndalimin e Pëllumb Kolbucajt dhe Abdullah Hardhiçajt (Pashaj), të cilët akuzohen si autorë të grabitjes së mbetur në tentativë të banesës së 62-vjeçarit Agron Veseli, të cilin edhe e dhunuan, duke vendosur kështu ndaj tyre masën e sigurisë "Arrest me burg". Por, në seancën gjyqësore dy të akuzuarit mohuan akuzën e ngritur ndaj tyre dhe madje fajësuan policinë se ka ushtruar dhunë mbi ta. Kolbucaj tha para trupës gjykuese të kryesuar nga gjyqtarja Irida Kacerja se ai është ndaluar pak metra larg banesës së grabitur, ndërsa po kthehej nga shëtitja e pasdites që bënte çdo ditë në pedonalen e Molos. "Nuk kam pasur kapuç në kokë siç thotë policia, por ma kanë vendosur ata dhe madje më kanë goditur, kam shenjat në trup. Unë kam rreth 100 krerë bagëti në shtëpi që merrem me to dhe nuk kam dalë për vjedhje. Të gjithë këtë po ma bën një oficer i policisë, i cili edhe më ka dhunuar. Po më bëjnë të vras veten. Thonë se e kam kryer në bashkëpunim me Abdullain, por ky nuk është në gjendje të qëndrojë as në këmbë. Dua të sqarohet e gjitha kjo, kaq kërkoj", tha 45-vjeçari Kolbucaj. Ndërsa Abdullah Pashaj pranoi se ka qenë për shëtitje në pedonale me Kolbucajn, por nuk ka lidhje me ngjarjen. "Gjatë shëtitjes në pedonale kam gjetur një çantë, ku brenda kishte 2 celularë, një palë targa makine dhe suze. Në orën 20:00 jam kthyer në shtëpi, ku celularët që ishin të fikur i vendosa në sirtar dhe targën me çantën në magazinë. Jam ulur më pas në klubin poshtë lagjes ku kam qëndruar deri në orën 23:30. Më pas shkova në shtëpi dhe kemi folur me djalin që e kam jashtë vendit. Kam qëndruar në kompjuter deri në mesnatë, kur më trokitën fort derë sa u tremba. Pashë që ishte policia. Më thanë hajde me ne, ndërsa më morën celularët, çantën dhe targat e më ofenduan. Kjo për mua nuk është normale, edhe sikur të jem me faj. Jo që unë i gjeta e s'kanë lidhje me atë që thonë. Më bënë presion të them gjëra që nuk qëndrojnë", u shpreh 53-vjeçari Pashaj. Ndërkaq, prokuroria e çështjes rrëzoi pretendimet e të pandehurve, duke thënë se në çantë janë gjetur maska, doreza, një levë, celularët. Ajo pohoi se ekzistojnë përgjimet ambientale mes dy të dyshuarve si dhe prova të tjera, shtuar këtu faktit se ata janë të dënuar më parë po për vjedhje. Gjithashtu, prokurorja tha se do të nisë hetimi dhe do të ketë ndjekje penale për punonjësit e policisë. Por avokati mbrojtës, Agim Martini shtoi se çanta nuk beson që ka lidhje me ngjarjen dhe duke marrë parasysh moshën e Pashajt dhe faktin që Kolbucaj ka 2 vajza të mitura dhe gruan sërish shtatzënë, t'i jepej masë më e lehtë. Këtij të fundit "arrest shtëpie me mbikëqyrje elektronike" dhe Pashajt detyrim paraqitje, ose arrest shtëpie. Por e gjykata rrëzoi këtë kërkesë dhe la në fuqi arrestin me burg të kërkuar nga organi i akuzës. Senad Nikshiqi




**NGJARJA**
Një grabitje e ngjashme me skenarët e filmave ndodhi të shtunën në Shkodër. Tre persona të maskuar dhe të armatosur hynë në shtëpinë e Agron Veselit dhe e kërcënuan se do ta vrisnin nëse nuk u jepte paratë". Pas ngjarjes, policia arrestoi Pëllumb Kolbucajn dhe Abdullah Hardhiçajn.

E martë 31 Korrik 2018 GAZETA SHQIPTARE

Sipërfaqja e tokës që do të marrë çdo familje në Kavajë, Kukës, Krujë e Gjirokastër

# Lista me 1476 personat që kanë gati lejet e legalizimeve

## ALUIZNI: Ja emrat e përfituesve në Durrës, Elbasan e Korçë

Voltiza Duro

ALUIZNI publikon listën me 5000 persona që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në Tiranë, Durrës, Berat, Elbasan, Gjirokastër, Kamëz, Kavajë, Korçë, Kukës, Lezhë, Lushnje, Krujë, Sarandë dhe Fier. "Gazeta Shqiptare" publikon sot emrat e 1476 përfituesve për qytetin e Durrësit, Elbasanit, Gjirokastrës, Kavajës, Korçës, Kukësit dhe Krujës. Drejtoria e ALUIZNI-t njofton qytetarët se duhet të paraqiten pranë zyrave të ALUIZNI-t për të tërhequr lejet ndërtimore. Ndërkohë që procedurat për marrjen e tapisë do të ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë. Kjo drejtori ka mbyllur të gjithë procesin për 5000 dosjet, të cilat tani kanë gati lejet dhe për pak ditë marrin certifikatën e pronësisë. Menjëherë pas regjistrimit të certifikatës së pronësisë, përfituesit do të njoftohen për tërheqjen e saj. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi, jo më shumë se 500 $m^2$. Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkese me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituara brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti. Ditën e nesërme "Gazeta Shqiptare" do të vijojë me publikimin e emrave të personave që kanë përfituar lejet e legalizimeve.

### LEJET E LEGALIZIMEVE

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | EMER | ATESI | MBIEMER | |
| 1 | YLLI | AVDULLA | TOSKA | |
| 2 | REXHEP | | MAKSUT | TEREZIU |
| 3 | ILIA | BASHKIM | KORDHIQA | |
| 4 | LULZIM | SULEJMAN | VESELI | |
| 5 | SAZAN | NESHAT | MUCOLLARI | |
| 6 | SHEFQET | | ABAZ | TEODORI |
| 7 | BEHAR | SHUAIP | HAJDARAJ | |
| 8 | EMRI | REXHEP | CANI | |
| 9 | XHEZMIJE | | TAFIL | KARAJ |
| 10 | GEGE | NIKOLL | MARKU | |
| 11 | KOCO | DHIMITER | TOPI | |
| 12 | MYLAZIM | | SELIM | GJINI |
| 13 | NAIM | REXHEP | HOXHA | |
| 14 | VASIL | MUHAMET | CELPICA | |
| 15 | EMINE | HALIT | HARIZAJ | |
| 16 | INDRIT | FADIL | BALLA | |
| 17 | RAIMOND | | HYSEN | KERCOVA |
| | ETLEVA | | | |
| | RUDIN | | | |
| 18 | MIMOZA | | PULLUMB | SEFERI |
| 19 | BARDHYL | | ABDULLA | KECI |
| 20 | AGIM | QAMIL | HALLULLI | |
| 21 | ISMAIL | OSMAN | LALA | |
| 22 | BASHKIM | | BAJRAM | MANUKA |
| 23 | SHABAN | | SELIT | SELAJ |
| 24 | BESJAN | MENTOR | DEMIRI | |
| 25 | INELDA | ELEZ | LIKA | |
| 26 | VALBONA | | PASHO | MILJA |
| 27 | SHAQIR | BAJRAM | DRAGJOSHI | |
| 28 | ALI | QAMIL | ZHELI | |
| 29 | XHEVAHIR | | FADIL | SHAHINI |
| 30 | NDRICIM | | FADIL | BALLA |
| 31 | EDUART | | HASAN | LIKA |
| 32 | REZART | | BARDHYL | GJEPALI |
| 33 | BESNIK | XHEVAHIR | XHANI | |
| 34 | ALTIN | SABRI | LLESHI | |
| 35 | BEKTASH | | XHEMAL | BANDE |
| 36 | QAMIL | TAHIR | BALLA | |
| 37 | XHEMAILE | | MAKSUD | XHERAJ |
| 38 | NEIM | ZEQIR | HODO | |
| 39 | QERIM | BANUSH | MERA | |
| 40 | DRITAN | ILJAS | MEMA | |
| 41 | JORGO | TEKI | HORANLLI | |
| 42 | DURIM | ZENUN | LILA | |
| 43 | RRUZHDI | | MUSA | VOCI |
| 44 | SHUAIP | YMER | CIMO | |
| 45 | HAMIT | SEJD | DEMIRAJ | |
| 46 | DALI | MYSLYM | DACI | |
| 47 | XHEMAL | | RAMADAN | DURRO |
| 48 | MAZLLEM | | NEDIM | HOXHA |
| 49 | HALIM | SHAQIR | PESHNJARI | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 50 | SAFET | QAZIM | NURCJA | |
| 51 | PETRIT | IBRAHIM | CORJA | |
| 52 | RASIM | CEL | HOXHA | |
| 53 | ILIRJAN | GURALI | DHEMBI | |
| 54 | KASTRIOT | | RAMADAN | AGOLLI |
| 55 | EVZI | SHAQIR | PESHNJARI | |
| 56 | PETREF | HAXHI | SHAHIPI | |
| 57 | GENTJAN | | FITIM | LUMI |
| 58 | MYSLYM | | SHERIF | ISMAILAJ |
| 59 | ASTRIT | BAJRAM | PIKU | |
| 60 | RIZA | ISMAIL | JANGULLI | |
| 61 | KOSTA | BASHKIM | KOURDHIQA | |
| 62 | ALKET | HASAN | LIKA | |
| 63 | ADRIAN | LEK | BICIKU | |
| | ALTIN | | | |
| 64 | FREDERIK | | MEHMET | MURATAJ |
| 65 | VELI | HEKURAN | FETA | |
| 66 | BEXHET | | QAZIM | SHEHI |
| 67 | KRENAR | HEKURAN | HAJDARAJ | |
| 68 | AGIM | MEHMET | KUQI | |
| 69 | ISMAIL | SHEFQET | MEMOLLA | |
| 70 | ERMIR | BASHKIM | KONI | |
| 71 | RIFAT | SULEJMAN | KURTI | |
| 72 | PELLUMB | SULEJMAN | | KURTI |
| 73 | ARTUR | ADEM | QAMA | |
| 74 | PAMAJOT | | FILIP | ANGJELO |
| 75 | HAJDIN | DAN | ISTREFI | |
| 76 | EDUART | | JASHAR | NEBELLI |
| 77 | ALBAN | IDRIZ | CANI | |
| 78 | HAXHI | TAHIR | SHKOZA | |
| 79 | PALI | STEFAN | PAPA | |
| 80 | LUAN | ZYBER | BOJA | |
| 81 | TONIN | PJETER | PRELA | |
| 82 | ELVIS | ARBEN | VRIONI | |
| 83 | ARBEN | KADRI | CULLHAJ | |
| 84 | ABAZ | FADIL | KAMERAJ | |
| | MANJOLA | | | |
| | TATJANA | | | |
| 85 | FERIT | XHAVIT | VOCI | |
| 86 | BASRI | MYSLYM | DEDEJ | |
| 87 | HAJRI | SHEFQET | JAHJA | |
| 88 | VISOR | ALI | MYFTARAGO | |
| 89 | VASIL | KOSTANDIN | KOCI | |
| | VASILIJA | | | |
| | MELLANIA | | | |
| 90 | SHKELZEN | | NAIM | MUCA |
| 91 | GEZIM | MUSTAFA | TABAKU | |
| | REDION | GEZIM | | |
| 92 | ISUF | ALI | DERVISHI | |
| 93 | SHAIP | XHELAL | YZEIRI | |
| 94 | ISMET | VELI | YZEIRI | |
| 95 | LULZIM | MASAR | MUCA | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 96 | BEQIR | GANI | BORICI | |
| 97 | SHYQYRI | | HYSEN | GURRA |
| 98 | XHEVDET | | ALI | KAJO |
| 99 | SKENDER | | HYSEN | KOCI |
| 100 | | QETSOR | FASLLI | SHINKO |
| 101 | | KADRI | SHABAN | ALLA |
| 102 | | ZEF | GJIN | PALI |
| 103 | | KUJTIM | SHEFKI | KALLBA- |
| QI | | | | |
| 104 | | FATJON | FARZI | ZIBA |
| 105 | | FATMIRE | DYLAVER | LICAJ |
| 106 | | FATMIR | SHEFKI | KALLBA- |
| QI | | | | |
| 107 | | SKENDER | RAM | GLLOGA |
| 108 | | FATJONA | ZIJA | ISTREFI |
| 109 | | NAZMI | QAZIM | COPANI |
| 110 | | GANI | KUKLI | KOVACI |
| 111 | | JORGJI | KOZMA | PRIFTI |
| 112 | | GEZIM | KAPLLAN | PIRACI |
| 113 | | NAIM | DEMUSH | LATIFI |
| 114 | | NAZMI | DYLEMAN | LIVANI |
| 115 | | LAVDIM | DILO | ALLKA |
| 116 | | LIMAN | MEXHIT | VOCI |
| 117 | SHPEND | REXHEP | KARAKUSHI | |
| 118 | ALTIN | IZVI | HOXHALLARI | |
| 119 | | HEKURAN | HYSEN | BUSHI |
| 120 | | ASTRIT | HALIM | HOXHA |
| 121 | | FIQIRI | FETAH | SHABANI |
| 122 | | SALI | FETAH | SHABANI |
| 123 | | AGIM | XHEVIT | ZOTOLLI |
| 124 | | XHEVDET | XHEMAL | SULA |
| | FLORE | ISMAIL | | |
| 125 | | ALTIN | TEME | CELA |
| 126 | NDUE | GJON | PERLLESHI | |
| 127 | | MAHMUD | SHKURT | |
| METHASA | | | | |
| 128 | | FATOS | SHABAN | HASKU |
| 129 | | SERVET | YDRI | KULLOL- |
| LI | | | | |
| 130 | | EDUART | LUTFI | QOSHI |
| 131 | | DURIM | HALIT | DACI |
| 132 | | KUJTIM | AVDULLA | SHAULLI |
| 133 | | MILORAND | MEDI | SALLAKU |
| 134 | | LUBIDIN | MYZAFER | DANJOL- |
| LI | | | | |
| 135 | | MENEHAN | MAHTIAR | PELIVANI |
| 136 | | QEMAL | VELI | KURTI |
| 137 | | KUJTIM | HASAN | FEZA |
| 138 | | HYSEN | RAMADAN | SHEHU |
| 139 | | RUDINA | RAKIP | DANI |
| | ROVEN | LUAN | | |
| 140 | | VASIL | MITRO | GERCO |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 141 | | SILVANA | SEFER | MERA |
| 142 | | LAURETA | TOMSON | LANI |
| 143 | | GERALD | HALIL | BEJDO |
| 144 | | BILBIL | ZENEL | KURTI |
| 145 | | GANI | HYSEN | KOCI |
| 146 | | FAREDIN | AVDI | NOKA |
| 147 | | ADRIATIK | SHAQIR | XHAMANI |
| 148 | | JONUZ | HAJDAR | DISHA |
| 149 | | AHMET | BAJRAM | BALOSHI |
| 150 | | MERSIN | HYVZI | BICI |
| 72 | XHEVDET | | KRRUSA | |
| 73 | ILIR | BAHA | | |
| 74 | FERDINAND | | TOÇI | |
| 75 | BESNIK | BUZANI | | |
| 76 | NDRIÇIM | | MUÇA | |
| 77 | AGRON | HAZMA | | |
| 78 | MUSA | KULLA | | |
| 79 | MONDI | ROÇI | | |
| 80 | MUSTAFA | | DEMIRI | |
| 81 | RIZA | MUÇA | | |
| 104 | | PETRIT | RUCI | |
| 167 | | GEZIM | META | |
| 168 | | SHPETIM | MEZINI | |
| 169 | | MUSA | HAZIZI | |
| 170 | | REFAT | ÇEKA | |
| 171 | | FATMIR | ÇARKU | |
| 172 | | FESTIM | BUDANI | |
| 173 | | BENARD | SHQAU | |
| 174 | | YLLI | ÇEKA | |
| 175 | | PETRAQ | DEDJA | |
| 176 | | SERVERI | MANÇKA | |
| 178 | | ARTAN | TAFANI | |
| 179 | | SABIRE | META | |
| 180 | | SHPETIM | GJELI | |
| 181 | | FERDINANT | TAFA | |
| 182 | | XHEVAHIR | NDREU | |
| 183 | | HAMIT | ÇERRI | |
| 184 | | ENTELA | QOSJA | |
| 185 | | BESNIK | ALLUSTAJ | |
| 186 | | HAXHI | TOÇILA ETJ | |
| 187 | | VIOLETA | PRIFTI | |
| 188 | | SULEJMAN | SHAHU | |
| 189 | | LUAN | VELIAS | |
| 190 | | FADIL | HUSHI | |
| 191 | | SEFEDIN | DERVISHI ETJ | |
| 192 | | THOMA | GUXHO ETJ | |
| 193 | | KUJTIM | AVDIA | |
| 194 | | MYZAJETE | KANA | |
| 195 | | GEZIM | GURABARDHI | |
| 196 | | GEZIM | ALLUSTAJ | |
| 197 | | DYLBER | BALLIU | |

| | | |
|---|---|---|
| 198 | STAVRI | TOÇI |
| 199 | SPIRO | KARAJ |
| 200 | ALBAN | KALIA |
| 201 | SELDI | MUÇA |
| 202 | BLEDAR | PISHA |
| 203 | ARTUR | ÇERRAGA |
| 208 | MIT-HAT | KYÇYKU |
| 231 | KLODIAN | AJREDINI |
| 245 | ADIL | MUSAI |
| 246 | SANIJE | BAROTI |
| 247 | DILE | DEDA |
| 248 | QAMIL | BOÇI |
| 260 | DHIMITER | DEDJA |
| 261 | HEKURAN | ÇEKREZI |
| 262 | ETMONT | KUKA |
| 263 | ILIR | GJATA |
| 264 | KUJTIM | BUDANI |
| 265 | GEZIM | TOLA |
| 266 | FADIL | RRANÇI |
| 267 | FATOS | HALIMLLARI |
| 268 | QERIM | KUKA |
| 269 | HETEM | BENO |
| 270 | KADRI | DANI |
| 271 | SKENDER | DIKA |
| 272 | BEHARE | PLAKA |
| 273 | XHEVAHIR | FAQOLLI |
| 274 | SHERIF | BALLKOÇI |
| 275 | OSMAN | HIDRI |
| 276 | BUKURIJE | FILJA |
| 277 | ALBERT | SINA ETJ |
| 278 | ABAZ | MALJA |
| 279 | XHEVAHIR | BALLIU |
| 280 | PELLUMB | LUKA |
| 281 | BARDHUL | META |
| 282 | QAMIL | LIÇI |
| 283 | FATMIR | JOLLA |
| 284 | BEXHET | CERRIKU |
| 285 | DRITAN | ALLUSTAJ |
| 296 | VANGJEL | KONINI |
| 297 | FAIK | FEÇI |
| 298 | GANI | TAHIRI |
| 299 | KADRI | BAKU ETJ |
| 300 | FLORENC | FILJA |
| 301 | EDMOND | BEGA |
| 320 | KUJTIM | GOGUJA ETJ |
| 337 | SPIRO | PANXHI |
| 338 | SELIM | DUSHKU |
| 339 | FLORENC | BORIÇI |
| 340 | GENTJAN | PALI |
| 341 | LULEZIM | ÇEPA |
| 342 | XHEVAHIR | RAMA |
| 343 | ANGJI | LLESHI |

MAVIJOSJE, ZHDUKUNI SA MË SHPEJT

SUMMER pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE

E martë 31 Korrik 2018



## Xhensila Myrtezaj, më në formë se kurrë



## Ronela tejet seksi, ja si duket këngëtarja

BULEVARDI POLITIK



- Majlinda Bregu më në formë se kurrë në plazh, djali e përqafon me dashuri
- Edi Paloka zbulon "vlerën e bajgës" së lopës
- Socialisti, me portofolin plot me euro e lekë. Ja si shkojnë në seancë deputetët
- Avokati Ngjela zbulon grykën ku kaloi Jul Qezari



Rrëfehet balerini: Situatat komike mes miqsh dhe pushimet e verës

# GRACIANO TAGANI: Ja si e siguroinë jetesën balerinët në Shqipëri

"Talenti, pasioni dhe vullneti të bëjnë kërcimtar"

## Rrëfehet balerini: Situatat komike mes miqsh dhe pushimet e verës

# Graciano Tagani:

## Ja si e sigurojnë jetesën balerinët në Shqipëri

### "Talenti, pasioni dhe vullneti të bëjnë kërcimtar"





Egla Xhemali

Ai e ka nisur baletin që i vogël. Në rrugëtimin përgjatë viteve të pasurit baletin si pasion u kthye edhe në profesion. Bëhet fjalë për Graciano Taganin. Për shumëkënd, ai u bë i njohur me pjesëmarrjen në "Big Brother", por tani që kanë kaluar shumë vite është rritur shumë profesionalisht, si dhe ka qenë mjaft aktiv në spektakle të ndryshme me epiqendër baletin. Këtë herë Tagani ndan me ne për suplementin "Summer Pages", se si e sigurojnë balerinët jetesën, ku sipas tij, profesioni i tyre nuk vlerësohet aq sa duhet. Graciano shquhet për pozitivitetin dhe natyrën e hedhur, e thotë se për të nuk ka pyetje të vështira që mund të drejtohen nga femrat dhe se këto të fundit janë të çmuara. Balerini na rrëfen momentet më komike të pushimeve mes miqsh. Nga eksperienca e tij në "Big Brother" pohon se nxori nga vetja durimin. Për të gjithë ata që kanë dëshirë që të bëhen kërcimtarë të mirë, Gracianio tregon se nga duhet t'ia nisin.

**Si e sigurojnë jetesën balerinët në Shqipëri?**

Ne ndeshemi me vështirësi sa i përket anës financiare, duke e ditur që profesioni ynë ka shumë mund dhe ne e realizojmë si gjithë të tjerët punën e profesionit që kanë. Prandaj, vetëm dëshira dhe pasioni i madh që kemi ndaj baletit na mban të motivuar duke e ditur që profesionin tonë nuk e vlerësojnë sa duhet financiarisht.

**Kushti parësor kur nënshkruan kontratat?**

Kushti parësor kur nënshkruaj kontratat janë kondicionet, që i vendos unë, që të mos kemi probleme më pas. Ku kryesoret për mua janë pagesa dhe imazhi im.

Çfarë është për ty një verë e jetuar në maksimum?

Të kalosh pushime me Rina Malsori dhe Argjira Spanca.

**Një moment komik gjatë pushimeve me miq?**

Një moment komik ishte gjatë pushimeve të mia në Jalë dhe ishte diku rreth orëve të para të mëngjesit dhe i thashë shoqes sime "Moj ça është ajo gjëja në ujë, është balenë"? - Ajo e pa dhe ma ktheu "po të ishte balenë nuk do rrotullohej në vend, po do lëvizte". Domethënë ishte shkëmb.

**Cila ka qenë pyetja më e vështirë që të ka bërë ndonjë femër?**

S'ka pyetje të vështira për mua, për shkak të natyrës së hedhur që kam.

**Taktika që përdor për të larguar femrat që nuk të pëlqejnë?**

S'ka femër që s'më pëlqen. Zoti na i ka bërë dhurata të çmueshme ato.

**Diçka që publiku nuk e ka parë në "Big Brother" ku ishe ti?**

As që më kujtohet me aq vite sa kanë kaluar.

Çfarë nxore nga vetja në "Big Brother", i detyruar nga izolimi?

Durimin.

**Në një jetë pasionante si tangoja, cila është lëvizja më e guximshme që do bëje?**

Nuk do guxoja, se është aq perfekte, sepse tango është pasion i gjallë.

**Fjalët që nuk do ua thoshe kurrë fëmijëve të tu?**

Mendoj që fjalët ofenduese nuk do doja t'i përdorja me ta.

Po të duam të bëhemi kërcimtarë të mirë, nga duhet t'ia nisim?

Nga talenti, pasioni dhe vullneti i madh.





# Xhensila Myrtezaj, më në formë se kurrë

Xhensila Myrtezaj u bë nënë për herë të parë më datë 12 korrik. Mes emocionesh, ajo dhe Besi e ndanë këtë lajm me gjithë ndjekësit e tyre në rrjetet sociale, duke postuar një foto në "Instagram", ku bënë me dije se e kishin pagëzuar me emrin Ajka. Që pas ardhjes në jetë të vogëlushes, bukuroshja thuajse ka qenë e shkëputur fare nga rrjetet sociale, pasi edhe postimet kanë qenë mjaft të rralla. Këngëtarja duket se i është dedikuar tërësisht vajzës së saj. Së fundmi, Xhensila ka ndarë me të gjithë fansat një foto në të cilën duket shumë e kuruar. E ulur në një makinë, Xhensila duket rezëllitëse. Mesa duket, mëmësia i ka dhënë edhe më shumë nur bukuroshes.





# Ronela tejet seksi, ja si duket këngëtarja

Ronela Hajati është e njohur për figurën e saj trupore, me të cilën "ngacmon" vëmendjen e ndjekësve të shumtë në rrjetet sociale. Publikimi i fotografive që vënë në pah linjat e këngëtares është shpeshtuar, teksa jemi në sezonin e verës. Gjatë fundjavës, ajo e ka publikuar një fotografi duke vënë në plan të parë të pasmet. Po duket se bukuroshja nuk do të ndalet me kaq. Së fundmi, Ronela ka postuar në "Instagram" një foto ku duket tejet seksi, e veshur me të zeza dhe me flokët biondë. Mesa duket, këngëtarja është duke sjellë projekte të reja për të gjithë fansat e saj.





# Aurela Hoxha lë pa fjalë me fotot e fundit

Aurela Hoxha është një nga modelet më të komentuara në 'showbizz'-in shqiptar për format dhe paragjykimet që i bëjnë për operacionet plastike. Bukuroshja është duke i shijuar pafund këto ditë të nxehta vere. Ajo ka qenë mjaft aktive në rrjetet sociale, duke ndarë me të gjithë momentet më të bukura nga ditët e pushimeve të saj. Këtë herë Aurela ka postuar një foto me rroba banjo të bardha, ku bie në sy fiziku perfekt i modeles. Jo të pakta kanë qenë komplimentet për bukuroshen.





# Roza Lati nuk di të ndalet

Roza Lati është një nga moderatoret më të dashura në Sh qipëri. Bukuroshja njihet për ekspresivitetin e saj dhe për shpirtin e lirë. Këto ditë ajo është duke shijuar pushimet në plazh. Jo të pakta kanë qenë fotot që ka publikuar moderatorja, duke i lënë të gjithë pa fjalë me format e saj. Së fundmi, Roza ka ndarë me të gjithë fansat në "Instagram" disa foto ku është e veshur me bikini dhe duket tepër seksi. Fansat kanë ngelur pa fjalë nga postimet e bukuroshes dhe nuk i kanë kursyer fjalët e mira për të.





Jeni zgjuar shpejt apo keni bërë një lëvizje të pakëndshme dhe jeni goditur. Menjëherë shfaqet mavijosje. Njolla vjollcë do të zhduket shpejt, nëse bëni disa truke.





# Mavijosje, zhdukuni sa më shpejt



Keni këmbë të gjata, muskuj të theksuar, supe të bukura... Megjithatë, planet ua prishin mavijosjet. Duke përcjellë disa këshilla të ekspertëve, do t'i eliminoni me lehtësi shenjat.

Kompresat e ftohta mund të pengojnë formimin e mavijosjeve, por nëse nuk keni pasur mundësi ta shfrytëzoni këtë metodë dhe vendi i goditjes tashmë e ka ndryshuar ngjyrën, është koha për kompresa të ngrohta, masazh të lehtë dhe fërkim të vendit që dhemb, sepse ngrohja sjell deri te resorbimi i gjakut të formuar nën të.

Në ditën e dytë pas goditjes, çdo dy orë lyeni vendin e lënduar me çfarëdolloj kremi ose xheli kundër mavijosjes dhe hematomës, por këtë bëjeni vetëm nëse nuk ka plagë. Gjethja e zakonshme e lakrës, e prerë, e qëruar do të shërbejë si kompresë e shkëlqyer që lehtëson dhimbjen dhe zvogëlon ënjtjen.

Veprim efikas ka edhe patatja e zakonshme. Zieni së bashku me lëvore një patate, pastaj qërojeni dhe shtypeni, shtoni pakëz mjaltë dhe ujë, ndërsa përbërjen e fituar vendoseni në vendin e mavijosur. E mirë është edhe uthulla, me të cilën njomet një leckë pambuku dhe lyhet vendi që dhemb disa herë në ditë.

*NDRYSHIMI I RËNDËSISHËM I NGJYRËS*

Shikojeni edhe si duket mavijosja. Në fillim, vendi i goditjes është me ngjyrë intensive të kuqe, pastaj kalon në ngjyrë vjollce, pastaj në të kaltër, të gjelbër dhe në fund e verdhë, e cila pas shërimit zhduket. Nëse pas goditjes nuk ndërrohet ngjyra, por nxihet, kjo është shenjë infeksioni, prandaj është e nevojshme të shkoni sa më shpejt te mjeku. Te disa njerëz madje edhe pas goditjes së fortë nuk shfaqen mavijosje, ndërsa te dikush mjafton kontakti i lehtë me një mjet të fortë. Shpesh nënshtresat vjollcë paraqiten te personat e moshuar, sepse me kalimin e viteve lëkura hollohet, ndërsa enët e gjakut janë më të dobëta. Por ky problem gjendet edhe te të rinjtë, sidomos nëse janë duhanpirës ose shpesh marrin preparate për hollimin e gjakut, siç është aspirina. Prirje për mavijosje kanë edhe personat të cilët nuk marrin sa duhet vitaminë C. Ata këshillohen të marrin më shumë pemë dhe perime, si edhe preparate multivitaminoze, nëse është nevoja. Lëkura është më e prirë për mavijosje edhe nëse është gjatë gjithë kohë e ekspozuar ndaj diellit. Nëse ju dalin shpesh mavijosje, të cilat nuk largohen edhe pas tri javësh, atëherë doemos shkoni te mjeku për këshillim, sepse ekziston mundësia të keni enë të dobëta të gjakut, prandaj duhet të mendoni për mënyrat e ndalimit të venave në këmbë, ose pëlcitjen e kapilareve në fytyrë.

*HEMATOMA*

Grumbullimi i gjakut nën lëkurë është i shpeshtë, nga ato më të voglat në formë mavijosjeve e deri te ënjtjet e mëdha, që janë si pasojë e përdredhjes së nyjave ose dëmtimit të muskujve. Hematoma paraqitet që pas goditjes ose tendosjes, pëlcet një ose më shumë enë të gjakut. Atëherë gjaku shpërndahet nën lëkurë. Te mavijosja bëhet fjalë për gjakderdhjen kapilare nën lëkurë. Në këtë rast sasia e gjakut është e vogël, por e shpërndarë në një sipërfaqe relativisht të madhe.

## Majlinda Bregu më në formë se kurrë në plazh, djali e përqafon me dashuri

Ish-deputetja e PD-së, Majlinda Bregu, e momentalisht sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, ka postuar një foto nga vendi ku po kalon pushimet. Bregu është shfaqur më në formë se kurrë në plazh, ndërsa shihet teksa e përqafon djali i saj. Të dy duken të buzëqeshur, teksa shijojnë ditët me diell në det. Bregu duket se po e shijon këtë periudhë të lirisë nga politika, por edhe angazhimet e përditshme partiake.




## Edi Paloka zbulon "vlerën e bajgës" së lopës

Në një nga seancat parlamentare, ku dihet se përdoret një fjalor tejet i "pasur" me sharje e fyerje, kryetari i grupit parlamentar të PD-së, Edi Paloka, i kujtoi kryeministrit Edi Rama një shprehje të Mao Ce Dunit. "Unë po ju citoj një filozof të madh të këtyre, Mao Ce Dunin. Shoku Mao ka thënë që bajga është më e vlefshme se dogma, se bajga të paktën bëhet pleh". E kryeministri Rama, që nuk të fal për kthim batutash e bëri të qartë aty për aty se këtë shprehje të Mao Ce Dunit, Palokës ia kishte thënë Berisha, që mund ta njihte më mirë figurën e Moas. "Është e qartë që burimi i citatit të Mao Ce Dun-it është dikush tjetër dhe mbi atë citat është ngritur edhe qenia 20 vjet deputet e këtij hotdokmës që foli përpara meje", i tha Rama, Palokës.



# BULEVARDI POLITIK

*Na merrni seriozisht!*

## Socialisti, me portofolin plot me euro e lekë. Ja si shkojnë në seancë deputetët

Dita e seancës parlamentare i gjen deputetët të përgatitur nga të gjitha drejtimet, edhe financiare. Pasi ajo zgjat e zgjat me orë të tëra dhe nuk i dihet nëse nata i gjen apo jo në shtëpi. Kamerat kanë filmuar një prej deputetëve socialist, duke numëruar në portofolin e tij eurot dhe lekët që i kishin mbetur. Nuk dihet se përse i janë dashur aq lekë, por gjithsesi, paraja është siguri. Pavarësisht se çfarë tesere partie mban, ky deputet përfaqëson të gjithë kolegët e tij, që në fakt pagat i kanë të larta dhe nuk e fshehin, se në fund të fundit "mbajnë" gjithë hallet e popullit.



## Avokati Ngjela zbulon grykën ku kaloi Jul Qezari

Avokati i njohur, Spartak Ngjela ka kohë që vendet e reja që shikon, i shfrytëzon edhe për të bërë një lloj reklame turistike për vendin. Në foton e fundit që ka postuar në "Facebook", Ngjela shkroi bashkëngjitur: "Kjo është gryka ku kaloi Jul Qezari në vitin 57 para erës së re, pasi zbarkoi poshtë, te plazhi i Palasës. Palestra e quan Qezari Palasën në ditarin e tij. Me poshtë është 'Fusha e Qezarit', vendi ku u grumbullua ushtria para se Qezari të hynte në Orikum. Asnjë shenjë nuk ka nga shteti shqiptar në 100 vjet", bën në këtë mënyrë edhe një kritikë për shtetarët ndër vite, Ngjela.



OPERA

# ZANA ÇELA: Jeta e Operës pa teatër

Opera "Carmen", produksioni më i madh i TKOB për këtë vit, me pjesëmarrje të artistëve vendës e të huaj, ka qenë sipas Zana Çelës, edhe më i suksesshmi në kalendarin e shfaqjeve nga janari deri në muajin korrik. Sipas drejtoreshës së TKOBAP, "premiera e operës 'Carmen' ka pasur shitjen më të madhe dhe audiencën më të madhe, por njëkohësisht për sa i përket audiencës edhe turi veror. Ne shkojmë aty ku publiku është, shkojmë për të kryer misionin tonë, por njëkohësisht edhe për t'i tërhequr e për t'i edukuar ata drejt artit klasik". Deklarata u bë dje në një konferencë për mediat, që shënoi edhe publikimin e një raporti vjetor të punës së këtij institucioni.

Janë rreth 20.000 mijë spektatorë, ata që kanë ndjekur këtë vit shfaqjet e TKOB, mes të cilave 3 premiera të Operës dhe Ansamblit Popullor si edhe 16 premiera koncertale. "Në 7 muajt e parë të këtij viti, Teatri i Operas ka realizuar gjithsej 57 shfaqje, duke rritur me 58% numrin e shfaqjeve, krahasuar kjo me 1 vit më parë, kur realizuam 36 shfaqje. Në shfaqjet tona kanë marrë pjesë 19.359 spektatorë, ose e shprehur ndryshe, 10% më shumë është rritur numri i spektatorëve tanë", deklaroi Zana Çela.

**KONFERENCA**

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor prezantoi në një konferencë për shtyp analizën 7-të mujore, janar–korrik 2018 të veprimtarisë artistike të tij. Drejtoresha e Përgjithshme e TKOBAP, Zana Çela, në fjalën e saj u shpreh se me marrjen e mandatit si drejtore e Përgjithshme e Teatrit të Operas e Baletit dhe Ansamblit Popullor një vit e gjysmë më par¸, është angazhuar në krye të stafit të Teatrit për ta kthyer Teatrin në një qendër të ekselencës, edukimit dhe inovacionit, duke siguruar një nivel të lartë dhe audiencë të gjerë.

"Garantimi i vazhdimësisë së veprimtarisë së institucionit gjatë periudhës së rikonstruksionit, duke shfrytëzuar skenat e Tiranës, qyteteve të tjera të vendit, ambientet 'open air' dhe duke ruajtur formatin e plotë skenik të produksioneve opera dhe balet. Zgjerimi i audiencave ndërkombëtare ishte një tjetër objektiv ambicioz. Gjatë muajve janar-korrik 2018 TKOBAP realizoi 16-të shfaqje jashtë kufijve të Shqipërisë. Kujtojmë këtu turneun e trupës së baletit në Itali me Stravaganza dhe Noces apo dhe turnetë e suksesshëm të Ansamblit Popullor në Belgjikë, Kroaci, Bullgari etj. Një vit më parë TKOBAP në të njëjtën periudhë kohore mundi të realizonte 2 koncerte. Gjatë sezonit janar-korrik 2018 TKOBAP nënshkroi dy protokolle shumë të rëndësishme bashkëpunimi me Teatrot Kombëtare të Serbisë dhe Maqedonisë për herë të parë në historinë e këtij teatri. Këto protokolle do të hapin rrugën e bashkëpunimit e bashkëprodhimit e si pasojë zgjerimit të audiencave tona ndërkombëtare", tha ajo.


Zana Çela

*"20 mijë spektatorë, na është rritur numri i ndjekësve në 'Instagram' e 'Facebook'"*

Sa u takon projekteve të edukimit, ajo tha se ka pasur angazhim. "Numri i aktiviteteve të organizuara në shkollat 9-vjeçare të Tiranës nga TKOBAP gjatë këtij 7 mujori ka qenë 34, kurse një vit më parë në të njëjtën periudhë numri i këtyre aktivitete ka qenë 2", - tha Çela.

Sa i takon mir¸menaxhimit të buxhetit dhe rritjes së të ardhurave nga sponsorizimet, marrëdhëniet me të tretët dhe të ardhurat nga biletat Çela vuri në dukje se të ardhurat nga sponsorizimet dhe bashkëpunimet me të tretët janë rritur në masën 75%, krahasuar rritjen në po të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe se të ardhurat nga biletat janë rritur në masën 255 % më shumë se 7-të mujori i parë i viti 2017.

Ajo tha mandej se aplikimi i metodave bashkëkohore të komunikimit, promocionit dhe marketingut të produksioneve për tërheqjen e audiencave, partnerëve, sponsorëve, medias, ka bërë që "dhe shifrat e realizimit të këtij objektivi flasin për rritje në krahasim me një vit më parë". Edhe këtë herë Çela renditi si arritje rritjen e numrit të ndjekësve në "Facebook" dhe "Instagram" me 58% më shumë se viti i kaluar; sikundër llogariti si sukses për rrjedhojë si shkak i punës në TKOB edhe numrin e artikujve të shkruar këtë vit të rritur sipas saj me 83% e po ashtu edhe numrin e kronikave televizive të realizuara nga mediat.

# BEKIM LUMI
## HUMB BETEJËN ME SËMUNDJEN E RËNDË REGJISORI I NJOHUR

Është ndarë nga jeta duket humbur betejën e vështirë me sëmundjen e rëndë në moshën 52-vjeçare regjisori Bekim Lumi. I lindur në Suharekë, gjatë viteve 1987–1991 ai ka studiuar Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Kurse gjatë viteve 1992–1996 ka mbaruar studimet për Regji Teatri, në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë, në klasën e profesor Agim Qirjaqit. Në të njëjtin universitet, me 2010 ka mbaruar edhe studimet e magjistraturës. Nga viti 2002 deri në vitin 2008 ka punuar si gazetar i fushës së kulturës në radion "Evropa e Lirë". Përgjatë këtyre viteve, ai ka punuar si regjisor i pavarur, në Teatrin Kombëtar të Kosovës, në Teatrin "Dodona" si dhe ka realizuar projekte teatrore me kompaninë e tij teatrore "Loja". Disa nga shfaqjet e tija kryesore janë: "Mësimi", "Galani", "Arushani & Fejesa", "Shtëpia e Bernarda Albës", "Çifti Martin", "Këmisha e gjakut", "Dillerat", "John Cage's Hamlet", "Nana dhe fëmija" dhe e fundit "Arturo Ui". Me shfaqjet e tija, ai ka qenë pjesëmarrës në dhjetëra festivale të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare, në Zvicër, Gjermani, Itali, Greqi, Rumani, Bosnjë e Hercegovinë e në vende të tjera. Bekim Lumi, me punën e tij si regjisor është shpërblyer me shumë çmime kombëtare e ndërkombëtare, ndër të cilat edhe: në vitin 2006, me shfaqjen "Mësimi", në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit në Lugano të Zvicrës ka fituar çmimin kryesor për shfaqjen më të mirë. Në vitin 2016 ka fituar "Çmimin Vjetor për Shfaqjen më të mirë", të cilën e ndanë Ministria e Kulturës e Kosovës. Lumi ka qenë botues dhe kryeredaktor i revistës së mirënjohur për teatër "Loja", e cila është botuar në Kosovë nga viti 2006 deri në vitin 2010. Bekim Lumi është autor i dhjetëra shkrimeve, analizave, studimeve e eseve për teatrin dhe përgjithësisht për skenën kulturore në Kosovë dhe më gjerë. Nga viti 2002 ka punuar si profesor në Fakultetin e Arteve, dega e regjisë së Teatrit. Në një intervistë për gazetaren Jorida Pasku, 9 vite më parë, Lumi i pyetur për propozimet regjisoriale këtu në Tiranë, thoshte se "trajtohen në mënyrë tradicionale, në mënyrë konvencionale, steriotipike, pa ide të reja regjisoriale. Gjithë problemi është se si mund të trajtosh në kontekst të shek. XXI, një kor antik. Çfarë kuptimi ka kori i tragjedive antike greke për sensibilitetin e njerëzve të shekullit tonë? Nuk është puna që ta marrim ashtu siç e ka thënë autori dhe ta nxjerrim në skenë. Për shembull korin e 'Persëve' të Eskilit, unë do ta trajtoja si një ritual të gjëmës shqiptare. Nuk do të orientohesha në skematizmin me të cilin janë mbushur skenat teatrore të botës shqiptare". Sipas tij, shqiptarët kanë një traditë të jashtëzakonshme etnologjike që do të ishte mirë të ishte prezente në shfaqjet shqiptare. Ai shtonte se nga tragjeditë antike ka pasur pak vënie si në Kosovë dhe në Shqipëri, e diku në vitin '92, regjisori Agim Qirjaqi ka vënë tragjedinë e Shekspirit "Rikardi III" dhe asokohe ka qenë një inskenim i mrekullueshëm. "E vlerësoj realizimin e Agim Qirjaqit për shkak të mënyrës bashkëkohore të trajtimit, të tejkalimit të disa konvencioneve tradicionale apo klisheve stereotipa, me të cilët asokohe dhe tani vazhdon të jetë i mbushur teatri shqiptar, në Kosovë dhe Shqipëri. Vlerësoj gjithashtu elegancën e jashtëzakonshme aristokratike, profesionale që Qirjaqi tregoi me 'Rikardin III" - shprehej Lumi.


Bekim Lumi

Ministrja e Kulturës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro i ka dërguar një mesazh ngushëllimi ministrit të Kulturës së Kosovës, Kujtim Gashi. Në mesazhin e saj, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë shpreh ngushëllimet e thella për humbjen e parakohshme të profesorit dhe regjisorit të artit skenik, Bekim Lumi. "Ikja e tij është një humbje e madhe për teatrin shqiptar. Me kontributin e tij të vyer në skenën mbarëkombëtare, me idetë novatore dhe risitë që solli, Bekim Lumi mbetet regjisori që sfidoi me art ikjen tokësore dhe i qëndroi skenës deri në momentin e fundit. I bashkohemi dhimbjes së Kosovës, familjes, artistëve dhe gjithë dashamirësve! Ai është artisti i të gjithë shqiptarëve. I paharruar, kujtimi i tij!", thotë Kumbaro.

"POETRYCARD"

# Christian Thanhäuser: Përse kam kaq dëshirë të vij në Shqipëri?

Poeteka hedh në qarkullim edicionin e pestë të botimeve që përurojnë kulturën përmes kartolinave letrare. Programi letrar “PoetryCard” organizohet nga Poeteka dhe mbështetet nga Ambasada e Austrisë në Tiranë (Austrian Embassy Tirana), si edhe partnerë te tjerë. Nisma nxit njohjen dhe leximin e autorëve austriakë në Shqipëri, por edhe paraqet krijimtarinë e disa autorëve shqiptarë që jetojnë në Austri dhe që shkruajnë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane. Nga ana tjetër programi “Poetry Card – Nga Austria me dashuri - From Austria to Albania with Love” bën të njohur edhe punën e shkrimtarëve dhe përkthyesve shqiptarë që kanë sjellë në gjuhën shqipe këta autorë, të tillë si Arshi Pipa, Lindita Arapi, Admira Poçi, Oriana Kraja Zylja, Majlinda Cullhaj në vijim e të tjerë që do të vazhdojnë programin. Pas suksesit me edicionet paraardhëse të kartolinave letrare, ku u publikuan ballina e revistës “Fryma”, 1944, në të cilën u paraqit një poezi e Rainer Maria Rilke-s, përkthyer nga Ars, botimet vijuan me nobelisten austriake Elfriede Jelinek (2004), e më tej me kartolinën e shkrimtarit dhe gazetarit të mirënjohur austriak, Joseph Roth, veshur me kostum tradicional shqiptar, me krijimtarinë poetike në dy gjuhë të shkrimtarit dhe përkthyesit Ilir Ferra. Edition i pestë i botimeve “Poetry Card – Nga Austria me dashuri - From Austria to Albania with Love”, sjell një ese të Christian Thanhäuser. Christian Thanhäuser është një artist austriak i njohur veçanërisht për punimet e tij grafike realizuar përmes teknikës së gdhendjen së dru. Ai është gjithashtu ilustrues i shquar librash dhe botues. Veç këtyre Christian Thanhäuser ka dhënë dhe jep kontributt të çmuar edhe përmes leksioneve të hapura nëpër Europë dhe Kinë, ku ai bashkëpunon me studentë mbi teknikat e artit grafik, bashkorganizon... work-shop-e apo master class-e mbi ilustrimin e librave, një prej të cilave ka qenë edhe në Universitetin e Arteve të Tiranës.


Christian Thanhäuser




*Eseja e artistit austriak, në programin e Poetekës*

**ESEJA E THANHÄUSER**

Hedh sytë prapa, në fëmijërinë time dhe shoh si u zgjua kureshtja ime për të huajën dhe se si u skicua rruga ime nga Austria veriore për në Shqipëri. Një ditë Maji me diell në vitet 70-të isha në lundrim mes Patras dhe Brindizit, në ngushticën detare mes Korfuzit e Butrintit dhe pashë për herë të parë Shqipërinë. Bregdeti më la një përshtypje përrallore.

Atëherë vendi për ne ishte i paarritshëm, por unë e dija se më vonë do ta shkelja atë vend. Christine von Kohl, njohësja e madhe e Shqipërisë, ma kishte futur në zemër vendin tuaj e më këshilloi të udhëtoja për këtu. Bëj diçka me të rinjtë. Vend është i mrekullueshëm, pak i njohur, por do ju pëlqejë, më tha. Në Frankfurt takimi i parë me Ardian Klosin, 1994 një mbrëmje letrare shumë prekëse me Kasem Trebeshinën në Ditët e Letërsisë të Rauris-it, unë duhej të ilustroja një libër të dytë të tij për shtëpinë botuese “Wieser”, fatkeqësisht ky projekt nuk u zbatua. Pasi Lindita Arapi, nëpërmjet këshillimeve të Annemarie Türk ishte bursante e Kultur-Kontakt Austria në Ottensheim, na tregoi mua dhe gruas sime Shqipërinë e saj, na njohu me familjen e saj të madhe dhe shokët e saj.

Nga ato takime lindi ideja, që unë të përgatisja një ekspozitë në Tiranë me gdhendjet e mia në dru. Shtangem çdo herë me bukurinë e vendit tuaj, u gëzohem njerëzve miqësorë të sinqertë dhe kjo shtangie mund të jetë pikënisje për vepra të reja arti dhe libra të rinj. Në 1989, pas nxitjes së H. C. Artmann, themelova një shtëpi botuese dhe pesë vite më vonë edhe një rezidencë me bursa për poetë. Lindita Arapi dhe Arian Leka ishin këtu, përveç miqve nga Çekia, Polonia, Hungaria,

Sllovakia, Rumania, Lituania, Turqia, Kroacia, Sllovenia, Ukraina, Kongo, Moldavia.

Të rriteshe si unë në banesën e mjeshtërve të lundrimit në Ottensheim, Linz, ishte gjurmëlënëse, njëlloj si rrjedha e Danubit. Shtëpia e fëmijërisë ndodhej në një pikë kryqëzimi të rëndësishëm të rrugëve tregtare mes ujit dhe tokës.

Deri në 1955 ky vend ishte një zonë e pushtimit rus, një vit më vonë u linda unë. Para shtëpisë, mbi Danub, ndodhet një urë e çeliktë dhe sytë e fëmijës ndjekin anijet e vendeve të ndryshme. Vetëm rrallë ndonjëra ankorohej në breg.

Kur ndodhte kjo, flitej menjëherë për kontrabandë shampanje. Mbresëlënës ishin ekskursionet me prindërit në pyllin e afërt të Bohemisë, në kufirin e atëhershëm me Çekosllovakinë me pamje mbi “vendin e ndaluar”. Kjo s‘më la të qetë deri sa mora patentën dhe u nisa menjëherë me makinë për në Pragë, ku ndihej ende e qartë bota e Kafkës.

***Përktheu Oriana Kraja-Oriona Kraja Zylja***

***(fragment nga eseja “Vetëm kufijtë e luhatshëm nuk janë mure”).***

## ORKESTRA E MBRETËRISË SË ARAGONËS, KONCERT NË TIRANË

Ambasadori i Spanjës në Shqipëri, Vicente Canelles, paraqet një koncert “në të cilin arti spanjoll bashkëkohor i shekullit XX tregon se nga vijmë, çfarë na dallon dhe atë çka disa artistë sollën në atë shekull në kulturën europiane. Prezantohen orkestra “Reino de Aragon” dhe dirigjenti i tyre, mjeshtrin Casero, tashmë i njohur për dirigjimin e tij edhe në koncerte të tjera në Shqipëri, që në këtë spektakël të çon në thellësitë e rrënjëve kulturore spanjolle.

Orkestra “Reino de Aragon” (ORA) është një formacion risi në nivel kombëtar, e themeluar në 2011 nga muzikanti aragonas, Sergio Guarne. Kjo orkestër ka realizuar më shumë se 43 produksione, 100 koncerte, duke kaluar kufirin e 125.000 pjesëmarrësve në spektaklet e saj. Ka realizuar regjistrimet Home Orchestra, 25 S ‘The return’ dhe “México, ahora y siempre”. ORA ka qenë orkestra rezidente në festivalin prestigjioz ndërkombëtar Riva del Garda (Itali) në edicionet e viteve 2014 dhe 2015, duke ndarë skenën me artistë të nivelit botëror si Natalia Gutman (violonçel), Aldo Ciçolini (piano), Sergey Ostrovsky (violin), ndër të tjerë. Gjithashtu, ka realizuar një produksion në bashkëpunim me Sarah Chang, një nga violinistet më të mira në botë, në një turne nëpër Gjermani dhe Turqi. Në aspektin social bashkëpunon ngushtë për themelimin e një sistemi edukativ në Uganda, Afrikë. Që prej vitit 2017 është formacioni rezident në Auditorin e Zaragozës. Kjo orkestër ka ngjallur kuriozitetin e producentëve në gjithë botën, duke marrë ftesa nga shumë shtete si Kina, Kanadaja, Zvicra, Franca, etj.



Elementët e ORA-s do të luajnë në bashkëpunim me elementë të Orkestrës së Operës Kombëtare të Shqipërisë. Magjia e tingujve spanjollë do të interpretohen nga instrumentistë spanjollë dhe shqiptarë, balerinë dhe këngëtarë solistë profesionistë. Me pjesëmarrjen e solistes Vikena Kamenica, Abigeila Voshtina dhe balerinëve Isida Mollaymeri dhe Erald Zela dhe orkestrime nga Gerti Druga. Koncerti do të zhvillohet tek teatri i ri “Turbina”, ditën e enjte, më datë 2 gusht në orën 20:00. Ky koncert sponsorizohet nga Ambasada e Spanjës, Ministria e Kulturës, Bashkia e Tiranës dhe Orkestra “Reino de Aragon”. Në program përfshihen Isaac Albéniz e Manuel de Falla.

Opinioni i Ditës

# Si po zhduket Tirana e romaneve të Kadaresë?

Nga Armand Shkullaku

*(vijon nga faqja 1)*

... të papërfshirë në interesa të ngushta politike dhe lidhje oportuniste me pushtetin e radhës. Me disa përjashtime të çmuara, pjesa më e madhe e atyre që mëtojnë të jenë elita iluministe e vendit, ka heshtur. Nuk kanë folur akademikë, mbrojtës të trashëgimisë kulturore, profesorë, filozofë apo artistë me renome edhe ndërkombëtare. Mes tyre, një zë që do të kishte vlerë të dëgjohej në mënyrë të veçantë, do të ishte ai i shkrimtarit tonë më të shquar, që jeton në Paris. Ismail Kadare do duhej të fliste. Pro ose kundër shembjes së kësaj godine. Tirana dhe ajo çka ka mbijetuar nga memoria e saj, janë në konstrukt të shumë prej veprave të tij.



Fama dhe mosha janë të mjaftueshme që shkrimtari të ndihet mospërfillës ndaj çdo paragjykimi për të thënë të vërtetën e tij. Tirana, ashtu si Gjirokastra apo Parisi, është gjithashtu qyteti i tij. Për të ka shkruar, në rrugët e tij ka ecur, në kafenetë e tij ka qëndruar për orë të tëra, brenda tij ka përjetuar rritjen, famën, ankthin, dramat, romancat, lindjen e fëmijëve, flirtet, xhelozitë, frikën nga një pushtet që mund ta godiste në çdo kohë. E ndoshta të gjitha këto ndjenja njëherësh mund t'i ketë provuar edhe tek një kafene e vetme, ajo e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe artistëve, pikërisht tek godina që sot duan t'i vënë kazmën.

Megjithatë, Ismail Kadare ende nuk ka folur. Qyteti i vizatuar me detaje në shumë vepra të tij po vdes çdo ditë. Lexuesi i sotëm nuk mund ta gjejë dot më Tiranën kadareane. Një nga një ranë të gjitha "skenat" ku gjallonin personazhet e tij. Nuk është më lulishtja e poshtme pas Skënderbeut, ku dikur bëheshin foto nën bredhat madhështorë. U zhdukën me radhë kinematë, ku adoleshentët prisnin fikjen e dritave për të prekur duart nën ethet e dashurisë së parë. Nuk janë as kinema "Republika", as "17 Nëntori", aq pranë ish-shtëpisë së shkrimtarit. U përçudnuan rrugët, u fshinë ndërtimet e vogla dhe kullat e betonit kanë murosur brenda tyre rrëfimet bashkë me personazhet, që dikur i jepnin shpirt edhe një qyteti të varfër, por që kishte botën e tij.

Nuk janë më sheshet përpara pallateve ku luhej me top, lulishtet e vogla ku putheshin në errësirë të dashuruarit, kopshtet, shkollat, parqet e lodrave, shtëpitë e rinisë, rrugicat e ngushta... të gjitha ato vende ku duhet të gjendeshin rrënjët e së shkuarës sonë. Edhe stadiumi, ku përjetoje dy orë pasion në një vend të zymtuar, nuk është më. Është një vend i shkretë, pa të shkuar, siç thoshte një shekull më parë Montanelli.

Pas fare pak kohe, këtij qyteti do t'i zhduket përmasa e Tiranës me të cilën na ka mbrujtur Kadareja.

Njerëzit nuk mund të kenë plotshmërinë e një qenie njerëzore në një vend të tillë. Ata rriten pa e ushqyer shpirtin e tyre, bëhen agresivë, materialistë, oportunistë, duan të jetojnë sot për sot, nuk kanë një rrëfim për fëmijët e tyre, janë me rrënjë të shkulura dhe pandërprerë zhvendosen me shpresën për të hedhur rrënjë diku tjetër. Atyre nuk u flasin as shkrimtarët e tyre, ata që të paktën në letër e kanë të ruajtur një pjesë të memories sonë të vrarë.

Mjafton të lexosh "Stambollin", apo "Muzeun e pafajësisë" të Pamukut (pa përmendur shkrimtarë të tjerë e vende të tjera) dhe të vizitosh atë qytet sot për të kuptuar sa e fortë është lidhja që vendi, godinat, parqet, rrugicat, krijojnë me njerëzit. Se si kjo lidhje i bën ata nostalgjikë, të ndjeshëm, krenarë, njerëzorë.

Në Tiranë vështirë të gjesh imazhe për të rindërtuar librat e Kadaresë. Sot ato janë dëshmi të një qyteti që nuk e njeh më askush. Si mund të jetë ndjenja e një shkrimtari kur lënda e veprës i vdes në të gjallë të tij?

Godina e Teatrit nuk është një vend i huaj për Ismail Kadarenë. Ajo gjendet shpesh në librat dhe kujtimet e tij. Aty nuk janë luajtur vetëm pjesë teatri, aty është luajtur edhe fati njerëzor i qindra njerëzve. Mbi të do të ngrihet një "teatër modern", i cili mund të mahnitë ata që lidhje kanë vetëm me materien të shprehur në formën e saj më të lartë, paranë. Ose ata që brohorasin për çdo vendim të partisë në këmbim të një projekti, pensioni, donacioni apo thjesht vetëm për t'i rënë në sy udhëheqësve të rinj. Por a është aq madhështor ky projekt sa mund të lërë pa prekur ndjeshmërinë e shkrimtarit?

Dikush mund të mendojë se ai është lodhur me banalitetet e kësaj ane. Ismail Kadare në fakt, nuk ka qenë rasti i shkrimtarit të izoluar nga bota dhe vendi i tij. Ai ka folur në momente delikate për fatin e shqiptarëve në tri dekadat e fundit. Nuk ka ngurruar ta lëshojë fjalën edhe për tema të nxehta politike si zgjedhjet e vitit '96 apo përplasjen Rama-Basha në 2011. Dhe pareshtur ka gjetur vullnetin të replikojë me çdokënd që ka hedhur dyshime për rolin e tij gjatë diktaturës komuniste. Fati i godinës së teatrit prek historinë e tij dhe historinë tonë të përbashkët, pra përbën një çështje ku mbi të gjitha do të vlente fjala e shkrimtarit.

Është debatuar shumë për rolin e tij si shkrimtar gjatë komunizmit. Askush nuk ka të drejtë sot t'i thotë atij se përse nuk bëri heroin dhe të dilte hapur kundër regjimit. Ai zgjodhi të shkruante. Dhe mirë bëri, një Kadare i gjallë ishte një shpresë më shumë në një vend të shkretuar. Por nëse heshtja e tij ishte e kuptueshme përballë marrëzisë së diktaturës, a duhet të flasë tani përballë marrëzisë së kllounëve? Nëse atëherë rrezikonte gjithçka për të shpëtuar asgjë, po sot që nuk riskon kurrgjë për të shpëtuar shumëçka?

**"Lapsi.al"**



Dje në "Evropa e Lirë"

# Vizitat e pamundura zyrtare në Serbi

Nga Bekim Bislimi

*(vijon nga faqja 1)*

... vlerësojnë zyrtarët e qeverisë së Kosovës dhe njohësit e zhvillimeve politike në vend.

Gjatë këtij viti, sipas tyre, janë shënuar një varg ndalesash dhe pengesash për sportistët, artistët, por edhe politikanët e Kosovës që të udhëtojnë për vizita zyrtare në Serbi.

Avni Arifi, shefi i ekipit teknik të Kosovës në dialogun me Serbinë, thotë për Radion Evropa e Lirë se verimet e autoriteteve serbe janë në krejtësisht në kundërshtim me frymën e dialogut dhe marrëveshjeve të arritura në Bruksel.

"Çfarë po shohim ne, është se qeveria e Serbisë, tash e një kohë të gjatë e ka degraduar në tërësi apo në masë të madhe procesin e lirisë së lëvizjes, ku shumë qytetarë të Republikës së Kosovës pengohen që të hyjnë në territorin e Republikës së Serbisë. Por flas, për sportistët, hendbollistët, karateistët, pastaj për artistët, të cilëve me thika u janë dëmtuar veprat artistike dhe në këtë mënyrë janë kontrolluar. Me fjalë të tjera, po flasim për një sjellje që tërësisht nuk është në frymën e asnjë marrëveshjeje, pra as marrëveshjes së Brukselit", tha Arifi.

Së fundmi, autoritetet e Serbisë nuk kanë lejuar vizitën e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Jashtëm të Kosovës, Bengjet Pacolli, i cili ka kërkuar të vizitojë Novi Pazarin, me ftesë të Këshillit Kombëtar Boshnjak.

Analisti i çështjeve politike nga Instituti Demokratik i Kosovës, Artan Murati, duke folur për Radion Evropa e Lirë, thekson që përkundër faktit se në marrëveshjen e arritur në Bruksel specifikohen rregullat që duhet ndiqen nga të dyja shtetet kur bëhet fjalë për vizitat zyrtare dhe shtetërore, në masë të madhe kjo marrëveshje nuk është respektuar nga shteti i Serbisë.

"Kemi qenë dëshmitarë të shumë rasteve ku janë ndaluar jo vetëm politikanë, por madje edhe artistë dhe sportistë nga Kosova. Kjo më së miri e shpërfaq qasjen që shteti serb e ka ndaj gjithçka që përfaqëson ose që lejon të përfaqësohet një Kosovë e pavarur, ose ku ka elemente të shtetësisë së Republikës së Kosovës. Pra, në momentin kur një delegacion ose një zyrtar udhëton në Serbi si përfaqësues i Republikës së Kosovës, kjo paraqet problem për shtetin e Serbisë dhe tendencat janë të vazhdueshme që të mos lejojnë që të ndodhë një gjë e tillë", theksoi Murati.

Në anën tjetër, shefi i Zyrës për Kosovën i Qeverisë së Serbisë, Marko Gjuriç ka theksuar për mediat serbe se zyrtarët kosovarë mund të vizitojnë Serbinë qendrore, nëse thirren në marrëveshjet për vizita dhe me kusht që funksioni i tyre ekziston sipas rregulloreve ndërkombëtare.

"Të gjithë zyrtarët që ekzistojnë sipas normave ndërkombëtare mund të thirren lirisht në marrëveshjet për vizita dhe të lëvizin në territorin e vendit të tyre. Por, të tillë nuk janë i ashtuquajturi ministër i Jashtëm i Kosovës apo i ashtuquajturi ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës, sepse krahina e jugut nuk ka funksione të tilla", ka thënë Gjuriç duke iu referuar Kosovës.

Por, interpretimet e tilla të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes, të cilat i bëjnë zyrtarët serbë, sipas Arifit, nuk duhet honepsur fare.

"Kosova është shtet sovran dhe i pavarur dhe me vetë faktin që në Bruksel ne po negociojmë me njëritjetrin, nënkupton që ne kemi marrëveshje ndërshtetërore të papërfunduara. Mënyra e interpretimit të tij (Gjuriçit) aq më bën. Ne po flasim për mosrespektim të marrëveshjes së shtetit të Serbisë ndaj shtetit të Republikës së Kosovës. Kështu e shohim dhe kështu do të jetë", u shpreh Arifaj.

Edhe analisti Murati thotë se Serbia po e shkel marrëveshjen për lëvizje të lirë, sepse kjo marrëveshje është bërë në frymën që të ofrojë ose mundësojë një bashkëpunim më të madh ndërmjet dy shteteve.

"Pra, duke iu mundësuar edhe zyrtarëve shtetërorë që të bëjnë vizita zyrtare në këto shtete dhe në njëfarë mënyre, të mundësojë që të paktën - përveç bashkëpunimit politik, i cili mund të jetë më i vështirë - edhe bashkëpunim në aspektin social, qoftë kulturor, artistik dhe sportiv dhe kështu me radhë. Mirëpo, këtu tejkalohen kufizimet, të cilat po i bën shteti serb për shtetasit e Kosovës, të cilët në këtë rast shkojnë ta përfaqësojnë Kosovën, në çfarëdo mënyre në Serbi. Kjo e tejkalon marrëveshjen e Brukselit dhe kjo tashmë është bërë një politikë ndaluese ndaj gjithçkaje që mban emblemën e Republikës së Kosovës", tha Murati.




Sportistët e Kosovës në dy raste brenda këtij viti nuk kanë arritur të marrin pjesë në gara me karakter ndërkombëtar, të cilat janë organizuar në Serbi, nën patronazhin e federatave përkatëse evropiane.

Ndeshja kualifikuese në kategorinë e femrave në grupmoshën nën 20-vjeç, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që ishte parashikuar të mbahej më 23 mars në Beograd, e vlefshme për Kampionatin Botëror të Hendbollit që do të mbahet në Hungari, nuk është zhvilluar pasi atë e kanë penguar autoritetet e Serbisë.

Kurse më 9 maj, përfaqësueses së Kosovës në karate, dy herë radhazi i është ndaluar hyrja në Serbi nga autoritetet e këtij shteti për të udhëtuar drejt Novi Sadit, ku u mbajt Kampionati Evropian i Karatesë, nga 10 deri më 13 maj.

Më 30 maj, autoritetet serbe nuk ua kanë lejuar artistëve të Kosovës që të bartin punimet e tyre artistike për në festivalin "Mirëdita, dobar dan!" që është mbajtur në Beograd.

## HOROSKOPI

### DASHI

Përmirësimi i shëndetit duhet të jetë prioritar për të lindurit në shenjën tuaj sot. Mos u tregoni kokëfortë përballë shqetësimeve fizike dhe mos lini pas dore gjërat, të cilat janë më të rëndësishme se paraja.

### DEMI

Frika mund t'ju dëmtojë anën psikologjike. Mendimet pozitive dhe optimizmi nga ana tjetër sjellin vetëm sukses në jetën tuaj. Disa fatura të papritura ose të harruara do të rrisin barrën financiare për të lindurit në shenjën tuaj.

### BINJAKET

Do të shijoni në maksimum kënaqësinë e kohës së lirë. Përmirësimi i financave është diçka e sigurt. Dashuria ka gjasa të mbetet në nivele jo të kënaqshme. Muzika është një ilaç hyjnor, që ju largon stresin.

### GAFORJA

Partneri juaj do të shqetësohet nëse nuk i kushtoni vëmendje të mjaftueshme. Mund të jeni duke kaluar një situatë të lodhshme në jetën në çift, por në asnjë moment mos hiqni dorë nga ajo që partneri pret nga ju.

### LUANI

Përdorni energjinë tuaj për të ndihmuar dikë në ankth. Një ditë kur të dëgjosh dhe të punosh mbi sugjerimet e njerëzve të tjerë, do të jetë e rëndësishme. Lidhja juaj romantike duket e acaruar, gjë që do t'ju shtojë presionin.

### VIRGJERESHA

Një ditë perfekte për t'u relaksuar. Jepini trupit mundësi qetësimi përmes masazheve. Kur fiziku juaj është në gjendje të mirë, edhe mendja jep 100 për qind. Nëse kohët e fundit keni pësuar zhgënjim në dashuri, do të kuptoni se ish-partneri juaj ka dalë më i humburi.

### PESHORJA

Investoni me mençuri në një projekt mbi të cilin nuk keni pasur shumë besim. Pavarësisht nga të gjitha problemet në jetën tuaj, partneri do t'ju qëndrojë pranë në çdo rast. Kur kaloni më shumë kohë me familjen se zakonisht, gjithmonë ekziston mundësia që të lindin disa fërkime.

### AKREPI

Jeta e dashurisë sjell shpresë për realizimin e ëndrrave tuaja. Një udhëtim me partnerin ju bën njeriun më të lumtur në botë. Mos u kurseni për ta realizuar këtë, sepse do të merrni frymëzim maksimal.

### SHIGJETARI

Merrni pushim të plotë për të rifituar energjinë. Investoni paratë në një projekt të sigurt. Nuk është dita e duhur për të marrë rreziqe mbi vete. Qëndroni larg thashethemeve dhe thashethemexhinjve.

### BRICJAPI

Në përgjithësi dita e sotme do të jetë e dobishme, por dikush tek i cili keni pasur besim, do t'ju zhgënjejë. Një plan për pushime të gjata nuk po funksionon si duhet. Mos u mërzisni, sepse edhe ky plan do të realizohet në një moment tjetër.

### UJORI

Ruani durimin edhe në situata të pakëndshme dhe nervozizmi në punë. Shmangni me çdo kusht një mosmarrëveshje me një koleg. Mos merrni vendime të nxituara për të cilat do të pendoheni më vonë.

### PESHQIT

Merrni pjesë në aktivitete që janë emocionuese dhe ju ofrojnë relaks. Sot është një nga ato ditë kur gjërat nuk do të lëvizin ashtu siç dëshiron. Sidoqoftë, bashkëshorti juaj do të jetë i mbushur me energji dhe dashuri.

Pyetja për popullin: A jeni për anëtarësimin në NATO e BE, me pranimin e marrëveshjes me Greqinë

# Maqedonia do votojë më 30 shtator për çështjen e emrit

## Votohen me 68 vota modelet e referendumit, opozita bojkoton

Isuf Kadriu

Maqedonia më 30 shtator do të votojë në referendum për Marrëveshjen me Greqinë për çështjen e emrit. Me 68 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i Maqedonisë ka votuar modalitetet e referendumit, i cili do të jetë konsultues dhe me pyetjen: "A jeni për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe BE me pranimin e marrëveshjes me Greqinë". Opozita nuk ka marrë pjesë në aktin e votimit, pasi paraprakisht kishte bërë të ditur se nuk mbështet referendumin. Kryeministri Zoran Zaev paraprakisht i kishte bërë thirrje VMRO-DPMNE-së të mbështesë referendumin si një proces shumë i rëndësishëm për të ardhmen e vendit, pasi me të, sipas tij, zhbllokohet procesi integrues, i cili është bllokuar tani një dekadë, pikërisht për shkak të kontestit së pazgjidhur të emrit. "Siç e dini, ky është një moment historik, jo vetëm për shkak të vendimit të referendumit, por edhe për shkak se përmes këtij vendimi, do të definohet e ardhmja e Maqedonisë. Edhe njëherë e shfrytëzoj rastin që opozita të përfshihet në këtë proces dhe të bëjë thirrje për dalje në votim, që qytetarët të dalin në numër sa më të madh për të dhënë votën e tyre", ka deklaruar kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev. Por, nga opozita kundërshtuan pyetjen e referendumit, sipas tyre për shkak të manipulimeve që tenton të bëjë pushteti me fshehjen e ndërrimit të emrit të shtetit. "Pyetja e referendumit është absolutisht manipuluese, pasi ligji për referendumin është shumë i qartë. Pyetja e referendumit duhet të jetë e kuptueshme, e thjeshtë dhe me një kuptim. Këtë që e ka paralajmëruar pushteti ka më shumë kuptime apo tetë deri në nëntë kombinime të mundshme. Dikush mund të jetë për anëtarësimin në NATO, por jo edhe në BE apo e kundërta, apo dikush të jetë për këto dy organizata, por jo edhe për marrëveshjen për ndërrimin e emrit", ka deklaruar Aleksandar Nikollovski, duke theksuar se qëndrimi i VMRO-së është i qartë, se pyetja e referendumit duhet të jetë ekskluzivisht për çështjen e ndërrimit të emrit të shtetit, që kjo parti e vlerëson si marrëveshje të dëmshme për identitetin, gjuhën, kulturën dhe veçoritë maqedonase. "Pyetja duhet të jetë e thjeshtë dhe e kuptueshme. Qytetarët duhet të përgjigjen se a janë apo jo për Marrëveshjen me Greqinë, që parasheh ndryshimin e emrit të shtetit. Pra, kjo të mos lidhet me integrimet në NATO dhe BE, për të cilat mund të ketë referendum të veçantë apo në të njëjtin referendum të këtë pyetje të veçantë për këtë çështje, por jo të përfshihen të gjitha në një", ka deklaruar Nikollovski. Ndërkohë, është zgjedhur edhe përbërja e re e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve që ka për obligim zbatimin e referendumit. Anëtarët e komisionit, pas betimit që bënë para kryetarit të Kuvendit, Talat Xhaferi, thanë se do të bëjnë çmos për organizimin me sukses të referendumit, në aspekt të përgjegjësive ligjore. Që referendumi të ketë sukses duhet të votojnë mbi 50 për qind e trupit votues që numëron rreth 1 milion e 800 mijë votues dhe nga ta, gjysma të deklarohet pozitivisht. Pas referendumit, nëse kalon me sukses, pasojnë ndryshimet kushtetuese me qëllim harmonizimin e dispozitave të saj me marrëveshjen me Greqinë, që parasheh emrin "Maqedonia e Veriut". Me zbatimin e marrëveshjes për emrin, si nga Maqedonia ashtu edhe nga Greqia, përfundimisht zhbllokohet procesin integrues, fillimisht me anëtarësimin e vendit në NATO dhe me hapjen e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian.



**ALEKSANDAR NIKOLLOVSKI**

"Pyetja e referendumit është absolutisht manipuluese, pasi ligji për referendumin është shumë i qartë. Pyetja e referendumit duhet të jetë e kuptueshme, e thjeshtë dhe me një kuptim. Këtë që e ka paralajmëruar pushteti ka më shumë kuptime apo tetë deri në nëntë kombinime të mundshme.Dikush mund të jetë për anëtarësimin në NATO, por jo edhe në BE apo e kundërta, apo dikush të jetë për këto dy organizata, por jo edhe për marrëveshjen për ndërrimin e emrit", ka deklaruar Aleksandar Nikollovski

### Lufta në Afganistan, përpjekjet diplomatike për ta mbyllur

## "Reuters": Takime sekrete mes SHBA dhe talebanëve, sinjalet janë pozitive

Shtetet e Bashkuara duket se po ndryshojnë kursin në politikën për Afganistanin. Ata po kërkojnë bisedime direkte me talebanët radikal-islamikë. Një takim mes të dërguarve të qeverisë amerikane dhe talebanëve në Afganistan duket se ka përfunduar me "sinjale shumë pozitive", raportoi "Reuters". Më parë kishin raportuar "Wall Street Journal" dhe "New York Times" duke iu referuar burimeve të talebanëve, se para rreth një jave, disa përfaqësues të islamistëve me të dërguarin amerikan për Azinë Jugore, Alice Wells dhe diplomatë të tjerë ishin takuar në Katar. Departamenti Amerikan i Shtetit nuk i hodhi poshtë njoftimet. Islamistët nuk duan të flasin me Kabulin. Që para dy javësh, "New York Times" kishte raportuar se administrata e Donald Trumpit kishte udhëzuar diplomatët kryesorë për të kërkuar bisedime direkte me talebanët për t'i dhënë fund luftës në Afganistan. Deri më tani, Uashingtoni kishte theksuar se talebanët duhet të negocionin me qeverinë në Kabul. Një proces paqeje duhet të zhvillohet nën drejtimin afgan. Islamistët e refuzojnë dialogun me qeverinë afgane si një qeveri marionetë. Në qershor, talebanët dhe qeveria e Kabulit arritën të mbanin një paqe treditore. Luftëtarë talebanë të paarmatosur dhe ushtarë shiheshin bashkë në rrugët e Kabulit dhe qytete të tjera. Një armëpushim i ri parashikohet më 22 gusht.



**TAKIMI**

Një takim mes të dërguarve të qeverisë amerikane dhe talebanëve në Afganistan duket se ka përfunduar me "sinjale shumë pozitive", raportoi "Reuters". Më parë kishin raportuar "Wall Street Journal" dhe "New York Times" duke iu referuar burimeve të talebanëve, se para rreth një jave, disa përfaqësues të islamistëve me të dërguarin amerikan për Azinë Jugore, Alice Wells dhe diplomatë të tjerë ishin takuar në Katar.



### Gjermania shpall në kërkim 300.000 veta, shumica e të cilëve islamistë

Sipas njoftimeve të medieve, policia gjermane është në kërkim të rreth 300.000 vetave të shpallur në kërkim. Ndër ta 126.000 të huaj, shumica e të cilëve janë islamistë. Gazeta "Welt am Sonntag" jep shifrat e sakta, duke iu referuar të dhënave të Entit Federal për Kriminalitetin në Gjermani. Sipas tyre, janë shpallur në kërkim saktësisht 297.820 vetë, 126.327 syresh të huaj. Ministria Federale e Punëve të Brendshme mendon se një pjesë të huajve të shpallur në kërkim duhet të jenë larguar ndërkohë nga Gjermania. Personat e shpallur në kërkim janë persona të burgosur për vepra penale që janë arratisur, të tillë që janë fshehur për t'i shpëtuar ndjekjes penale, ose persona që konsiderohen si rrezik për rendin publik. Sipas autoriteteve, ndër personat e shpallur në kërkim ka një rritje të numrit të personave që kanë kryer vepra penale me motive politike. Në krahasim me një vit më parë, numri i personave të shpallur në kërkim për vepra të tilla është trefishuar dhe fjala është për 4.411 vetë. Shumica e tyre janë islamistë. Armin Schuster, bashkëkryesues i Komisionit për Punët e Brendshme të Bundestagut kërkoi përpjekje më të mëdha për arrestimin e të huajve, të cilët janë fshehur për t'i shpëtuar dëbimit nga Gjermania. Ai kërkoi që për këtë qëllim policia të përdorë metodën e kontrollit të automjeteve apo të personave edhe pa pasur raste dyshimi, metodë e cila në Gjermani zakonisht përdoret për arsye sigurie në raste konferencash të rëndësishme ndërkombëtare.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al